

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5740
E hënë, 1 prill 2019
çmimi 0.40 €

Mbi 700 vjedhje për dy muaj në Kosovë



FAQE 6

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AHMET ISUFI ■ FAQE 4-5

Koalicioni po funksionon, s'ka zgjedhje të reja

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka mohuar se koalicioni qeverisës ndodhet në krizë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se dallimet eventuale për ndonjë çështje të caktuar nuk do të ndikojnë në zbehjen e raporteve ndërmjet partnerëve të koalicionit qeverisës. Isufi ka treguar edhe se si mund të tejkalohen këto dallime. Nënkrjetari i AAK-së nuk beson se mund të ketë zgjedhje të parakohshme në këtë verë. Sipas tij, për një gjë të tillë nuk shihet interesim as te dy partitë më të mëdha opozitare të cilat po kërkojnë zgjedhje. Isufi në këtë intervistë ka theksuar se taksat 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë do të vazhdojnë të qëndrojnë



AKTUALE

AFORIZMA PËR POLITIKANËT QË DËGJOJNË (II)

F. 11



Prof. Lisen BASHKURTI

LIMAJ NË PËRVJETORIN E MASAKRËS SË BURIMIT BËN THIRRJE PËR ZBARDHJEN E KRIMEVE SERBE NË KOSOVË F. 5

SBASHK-U KËMBËNGUL: S'DO TË KETË KOMPENSIM TË ORËVE F. 5

EKONOMI

REÇICA NË FERIZAJ FTON BIZNESET DHE PUNËKËRKUESIT TA VIZITOJNË PANAIRIN E PUNËS F. 9

BQK-ja ORGANIZOI LIGJËRATË PËR TREGUN E LETRAVE ME VLERË F. 9

KULTURË

HORIZONTI I SË KALUARËS DHE SFONDI SOCIAL NË ROMANIN 'MISIRI I VOGËL' F. 13

Ferdi KAMBERI

SPORT

LORIANA KUKA IA SJELL MEDALJEN E DYTË TË ARTË KOSOVËS F. 13

FLAMURTARI I BËRI NDER PRISHTINËS, NDALI FERONIKELIN NË 'FADIL VOKRRI' F. 14

VAZHDIMI I DIALOGUT, PAS ZGJEDHJEVE NË BE

Njohësit e proceseve politike kanë vlerësuar se aktualisht nuk ka kushte për vazhdimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Analisti Behxhet Shala ka thënë se zgjedhjet në Bashkimin Evropian kanë humbur interesimin për vazhdimin e këtij procesi pasi, sipas tij, shumë shtete evropiane nuk janë të kënaqura me udhëheqjen e Mogherinit dhe të Hahnit. Shala ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se procesi i dialogut pritet të vazhdojë pas zgjedhjeve të Parlamentit



Evropian. Edhe ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se për të vazhduar dialogu i Brukselit ndërmjet dy shteteve duhet pritur udhëheqësinë e re të Bashkimit Evropian ■ FAQE 3



Vetëm 12.7 për qind e femrave të punësuar, kërkohet përkrahje nga qeveria ■ FAQE 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Sot fillon fushata, kandidatët firmosën kodeksin për zgjedhje korrekte

Një ditë para fushatës zgjedhore për president të Maqedonisë Veriore, që nis sot (e hënë), tre kandidatët për president shteti, Blerim Reka, Gordana Siljanovska dhe Stevo Pendarovski, nënshkruan kodeksin për zgjedhje korrekte dhe demokratike



SHKUP, 31 MARS - Tre kandidatët për president shteti, Blerim Reka, Gordana Siljanovska dhe Stevo Pendarovski, një ditë para fillimit fushatës, nënshkruan kodeksin për zgjedhje korrekte dhe demokratike. Të tre kandidatët u zotuan se do të zhvillojnë fushatë demokratike dhe të drejtë, duke uruar njëri-tjetrin për një garë të shëndoshë. "Unë shpresoj se do të jetë një garë fer, ligjore dhe e rregullt. Fundja, nuk është aq me rëndësi se kush fiton, por me rëndësi është që Republika e Maqedonisë së Veriut do të fitojë dhe ta fitojë datën për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE", deklaroi Blerim Reka, kandidat i pavarur për president, i cili mbështetet nga Aleanca & Besa.

Ndërkaq kandidatja e VMRO-DPMNE-së, Gordana Siljanovska, tha se pret një betejë kalorësish me argumente e jo me lojëra bizantinësh. "Bashkëpjesëmarrësit në zgjedhje nuk i shoh si armiq, ndërsa neve grave nuk na ka hije që të mos e respektojmë etikën. Edhe pse jam grua, pres një betejë kalorësish me argumente e jo me lojëra bizantinësh. Mendoj se fjalën e fundit do ta kenë qytetarët", tha Gordana Siljanovska, kandidate e VMRO-DPMNE-së për presidente. Edhe kandidati i LSDM-së, Stevo Pendarovski, thotë se ajo që u nënshkrua sot do të respektohet në terren. "Edhe pse sot jemi dëshmitarë të

proceseve paraprake zgjedhore, ku diçka tjetër është nënshkruar e diçka tjetër është bërë, në emrin tim, jam i bindur, por edhe në emër të kundërkandidatëve të mi formalë, sepse ne nuk jemi prej dje para opinionit, mund të garantoj se kjo që sot e nënshkruam do të zbatohet praktikisht në terren", u shpreh Stevo Pendarovski, kandidat i LSDM-së për president.

Nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve gjithashtu presin që të respektohet Kodi Zgjedhor jo vetëm nga kandidatët, por dhe nga partitë dhe simpatizantët. "Kjo është një vepër e mirë dhe e shkëlqyer. Ne të gjithë do të mundohemi që ta realizojmë fushatën zgjedhore dhe këto zgjedhje presidenciale të përfundojnë në mënyrë të drejtë, korrekte dhe demokratike, ndërsa ne ta demonstrojmë kapacitetin demokratik të shtetit dhe të qytetarëve të shtetit tonë", deklaroi Oliver Derkovski, kryetar i KSHZ-së. Sipas radhitjes, kandidati i pavarur, i mbështetur nga opozita shqiptare, Blerim Reka, do ta kryesojë fletëvotimin, numri dy i takon kandidates së VMRO-DPMNE-së, Gordana Siljanovska, ndërsa numër tre është kandidati i LSDM-së dhe koalicionit, Stevo Pendarovski. Fushata zgjedhore fillon sot (e hënë), ndërsa zgjedhjet do të mbahen më 21 prill. Të drejtë vote kanë rreth 1.8 milion qytetarë.

Institucionet, të përgatitura për zgjedhjet presidenciale

SHKUP, 31 MARS - Institucionet e vendit shprehen tërësisht të gatshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor për zgjedhjet presidenciale dhe për zgjedhjet e pjesshme lokale të 21 prillit. Nga KSHZ thonë se kanë marrë të gjitha masat për të zhvilluar një proces të drejtë dhe demokratik.

"Si çdo aktivitet që kryen KSHZ-ja ashtu edhe aktivitetin me fushatën zgjedhore në vazhdimësi është duke punuar në aspektin e një fushate të drejtë, korrekte dhe demokratike. Sa i përket kësaj çështje KSHZ është duke punuar edhe në nënshkrimin

e Kodit për fushatën të cilën do ta zhvillojnë kandidatët për president të shtetit me qëllim që kandidatët t'u përmbahen të gjitha rregullave dhe që të kemi një fushatë sa më korrekte dhe demokratike nga ana e tyre", tha Admir Shabani nga KSHZ. Nga MPB gjithashtu thonë se janë në nivel të detyrimeve ligjore që ndërlidhen me aktivitetet parazgjedhore të kandidatëve presidencial.

"MPB-ja, tanimë është e përgatitur për zgjedhjet e radhës. Kemi bashkëpunim të shkëlqyer me institucionet e tjera dhe veçanërisht me

KSHZ-në. Në nivel të MPB-së është formuar shtab operativ dedikuar zgjedhjeve, kështu që jemi tërësisht të përgatitur për zgjedhjet e radhës presidenciale. Apeloj te qytetarët që së bashku të mundësojmë proces zgjedhor të qetë dhe të drejtë zgjedhor dhe mund të them se MPB-ja tërësisht është e përgatitur për këtë proces", tha Toni Angelovski nga MPB-ja. Përveç me MPB-në nga KSHZ njoftojnë se janë në komunikim permanent me edhe me organe të tjera, puna e të cilave është ngushtë e lidhur me punën e KSHZ-së.

Cakaj thotë se raporti i DASH-it është realist

TIRANË, 31 MARS - Ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj, thotë se raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, për strategjinë e luftës ndërkombëtare kundër narkotikëve, ofron një pasqyrë realiste dhe është inkurajues për reformat e ndërmarra. Sipas raportit, Shqipëria vlerësohet të jetë burim i kanabisit dhe, gjithnjë e më shumë, një vend transit për kokainën dhe heroinën, ndërkohë që flet për kontrollin e trafikut të heroinës nga grupet kriminale, korrup-

sionin e përhapur që kufizon përpjekjet në këtë luftë dhe përparimin e pamjaftueshëm kundër pastrimit të parave. Për ministrin Cakaj, raporti vë në dukje se, sipas tij, "vendi ka shënuar arritje thelbësore në luftën kundër narkotikëve dhe kriminit të organizuar" dhe se "bashkëpunimi i qëndrueshëm me Shtetet e Bashkuara është përkthyer në rritje të kapaciteteve për ta luftuar korrupsionin". Cakaj tha se raporti afirmon rezultatet e shënuara në reformën

në drejtësi.

Reagimi i ministrit erdhi menjëherë pas publikimit të raportit dhe kritikave të forta që pasuan nga ana e opozitës. Kryetari demokrat, Lulzim Basha, tha se raporti është dokument shkatërrimtar për Shqipërinë, për gjendjen e kriminit, drogës, pastrimit të parave, korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe kapjes së shtetit.

Ndërsa nënkryetari i LSI-së, Luan Rama, tha se është e turpshme që Shqipëria të vazhdojë të jetë, vendi i akuzuar për



trafikun e lëndëve narkotike, pastrimin e parave, korrupsionin dhe për rolin e saj si një vend

ndërmjetës për trafikun e drogave të forta, e për kriminin e organizuar.

Vazhdimi i dialogut, pas zgjedhjeve në BE

Njohësit e proceseve politike kanë vlerësuar se aktualisht nuk ka kushte për vazhdimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Analisti Behxhet Shala ka thënë se zgjedhjet në Bashkimin Evropian kanë humbur interesimin për vazhdimin e këtij procesi pasi, sipas tij, shumë shtete evropiane nuk janë të kënaqura me udhëheqjen e Mogherinit dhe Hahnit. Shala ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se procesi i dialogut pritet të vazhdojë pas zgjedhjeve të Parlamentit Evropian. Edhe ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se për të vazhduar dialogu i Brukselit ndërmjet dy shteteve duhet pritur udhëheqësinë e re të Bashkimit Evropian



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINE, 31 MARS - Analisti politik Behxhet Shala ka thënë të dielën se procesi i dialogut Kosovë - Serbi nuk mund të vazhdojë pa përfunduar zgjedhjet në Parlamentin Evropian. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se tani për tani nuk ka kushte për vazhdimin e këtij procesi. "Na ndajnë dy muaj nga zgjedhjet në Parlamentin Evropian, prandaj për këta dy muaj nuk besoj se mund të arrihet ndonjë përparim në procesin e dialogut, aq më parë kur deri tani ka pasur vendnumërim. Njëherë përnjëherë nuk ka kushte për dialog. Edhe Serbia, si duket, nuk është e interesuar për dialog dhe po e përdor heqjen e taksës si pretekst. Në fakt, taksa nuk do të duhej t'i pengonte sepse deri më tani dialogu ka qenë i

pakushtëzuar. Ndërkaq edhe Kosova nuk po e heq taksën dhe në një farë mënyre nuk është e interesuar për dialog", është shprehur Shala, duke shtuar se Kosova dhe Serbia kanë frikë nga vazhdimi i dialogut. "Të dy vendet sikur kanë frikë për vazhdimin e dialogut sepse ky dialog dhe një marrëveshje eventuale siç po flitet në opinion është marrëveshje që ua 'han kokën' Vuçiqit dhe Thaçit. Domethënë, as Vuçiqi e as Thaçi nuk kanë interesim ta arrijnë një marrëveshje siç po supozohet. Prandaj po gjejnë arsye për ta shtyrë dialogun dhe arsye më të mirë për ta bërë këtë nuk ka sesa zgjedhjet që do të mbahen në Bashkimin Evropian. Përbërja aktuale nuk ka mandat për ta çuar deri në fund këtë proces, por po pritet përbërja e re e Parlamentit Evropian. Kjo është një mundësi e mirë për të gjithë ata që nuk duan ta vazhdojnë

dialogun Kosovë - Serbi. Është një mundësi e mirë edhe brenda disa shteteve të BE-së ta shtyjnë dialogun për faktin se kanë hezitime se kjo marrëveshje nuk mund ta zgjidhë çështjen midis Kosovës dhe Serbisë", ka deklaruar ai. Shala ka vlerësuar se vazhdimi i dialogut në këtë periudhë nuk do të kishte efekt sepse, sipas tij, BE-ja nuk ka kohë të merret me këtë proces. Ai ka theksuar se Federica Mogherini e ka bastarduar procesin e dialogut për normalizimin e raporteve ndërmjet dy vendeve. "Vetëm Federica Mogherini me ekipin e saj mund të merren me dialog,

por edhe kësaj i ka humbur kuptimi sepse ajo i ka ndërruar kahen dialogut, e ka bastarduar dialogun. Ne vend se ta kemi një dialog për zgjidhjen dhe arritjen e një marrëveshje të pranueshme për të dyja palët, ajo ofron një zgjidhje bastarde e cila vetëm sa do të hapë probleme në të ardhmen. Është një situatë interesante, nuk ka interesim prej shteteve të BE-së që të vazhdohet dialogu. Së paku ata e thonë deklarativisht, mirëpo jo që këmbëngulin për këtë dialog. Megjithatë, është një disponim i përgjithshëm evropian që të mos ketë dialog, aq më parë që ata janë të preokupuar me zgjedhjet në BE, fitimin e mandateve të reja dhe hartimin e një garniture tjetër udhëheqëse për politikë të jashtme, meqë kemi parë shumë shtete evropiane që nuk janë të kënaqura me udhëheqjen e Mogherinit dhe Hahnit", ka thënë Shala, duke shtuar se është e çuditshme se vetëm amerikanët janë duke bërë presion për rifillim të dialogut. Sipas tij, letra e presidentit amerikan është me shumë paqartësi. "Është për çudi që presioni më i madh për vazhdimin e dialogut po vjen nga amerikanët dhe pikërisht nga ajo letra e Trumpit e cila, për bindjen time, nuk ka diçka pozitive për Kosovën. Është letër me

shumë të panjohura dhe më shumë paqartësi e cila pas një kohe mund t'i vendosë para aktit të kryer dhe pas së cilës nuk mund të bëhet asnjë korrigjim, pavarësisht nëse palët do të ndahen apo jo të kënaqur me një marrëveshje eventuale. Prandaj mendoj se për vazhdimin e dialogut duhet të presim për disa muaj", ka deklaruar Shala. Edhe ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se për të vazhduar dialogu i Brukselit ndërmjet dy shteteve duhet pritur udhëheqësinë e re të Bashkimit Evropian. Ajo ka vlerësuar se tani nuk është koha për marrëveshjen përfundimtare Kosovë - Serbi. Tahiri e ka akuzuar shpen e politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini, se ka tradhtuar parimet evropiane. "Qëndrimi ynë si Kosovë duhet të jetë që të mos kemi marrëveshje në këtë kohë. Pra, të presim të shkojë Mogherini e cila ka tradhtuar parimet evropiane dhe t'i presim ndryshimet në udhëheqjen e BE-së. Shpresojmë të vijë një udhëheqje që mbron parimet evropiane të integritit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE ashtu siç është konfirmuar edhe me strategjinë e fundit për zgjerim të BE-së", ka deklaruar Tahiri për gazetën "Epoka e re".



Hyzer Rizani zgjedhet kryetar i ri i PDK-së në Lipjan

LIPJAN, 31 MARS (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka përmbyllur të dielën zgjedhjet e brendshme në Degën e Lipjanit, ku me shumicë të votave të delegatëve, në një garë të ngushtë me katër kandidatë, kryetar i degës u zgjodh, në raundin e dytë, doktori i shkencave, Hyzer Rizani. Kryetari i ri i PDK-së në Lipjan, i

cili deri në zgjedhjet e fundit ka qenë kryetar i Rinisë Demokratike në Lipjan, ka falënderuar delegatët për besimin e dhënë dhe u zotua se do të punojë pandërprerë për vazhdimin e sukseseve të PDK-së në Komunën e Lipjanit. Para procesit të votimit, katër kandidatët për kryetar dege

paraqitën platformat e tyre para qindra delegatëve, për çka u vlerësuan në emër të kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, për garën fer e demokratike gjatë gjithë procesit zgjedhor. Tre kandidatët e tjerë për kryetarë e uruan kryetarin e ri Rizani për fitoren, duke i shprehur mbështetje të plotë në rrugëtimin

e ri në krye të degës, për ta fuqizuar dhe jetësuar platformën Dekada e Re për qytetarët e Lipjanit. Kuvendi zgjedhor, ku ishin të pranishëm 270 delegatë, po ashtu zgjodhi Këshillin Drejtues të degës prej 71 anëtarëve si dhe 15 delegatë për Konventën Qendrore. Para të pranishmëve, kryetarja e

deritashme e degës, Selvie Halimi, ka falënderuar mbi 2 000 pjesëmarrës në 55 nëndegët e Degës së Lipjanit. Para të pranishmëve, nënkryetari Hajredin Kuçi, njëherësh edhe kryetar i Komisionit Zgjedhor, ka thënë se Kuvendi Zgjedhor në Lipjan dëshmon se sa e fortë është PDK-ja në Lipjan.

Flet për "Epokën e re", Ahmet Isufi

Koalicioni po funksionon, s'ka zg



Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka mohuar se koalicioni qeverisës ndodhet në krizë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se dallimet eventuale për ndonjë çështje të caktuar nuk do të ndikojnë në zbehjen e raporteve ndërmjet partnerëve të koalicionit qeverisës. Isufi ka treguar edhe se si mund të tejkalohen këto dallime. Nënkryetari i AAK-së nuk beson se mund të ketë zgjedhje të parakohshme në këtë verë. Sipas tij, për një gjë të tillë nuk shihet interesim as te dy partitë më të mëdha opozitare të cilat po kërkojnë zgjedhje. Isufi në këtë intervistë ka theksuar se taksë 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë do të vazhdojë të qëndrojë

shtetëror. Sipas Isufit, dallimet mes tyre mund të eliminohen duke komunikuar partnerët më shumë mes vete. "Këto dallime në ndonjë çështje në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës mund të kalohen duke komunikuar në mënyrë institucionale liderët politikë. Meqenëse kemi të bëjmë me çështje kapitale për vendin, atëherë duhet të ketë më shumë komunikim të brendshëm në mënyrë që të mos reflektojnë në opinion mendimet e tilla kundërtë", është shprehur Isufi.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së nuk beson se vendi mund të shkojë drejt zgjedhjeve të reja këtë verë. Isufi ka deklaruar se nuk shihet interesim për zgjedhje të reja as te dy partitë më të mëdha opozitare të cilat po kërkojnë zgjedhje. "Njëherë përnjëherë nuk ka shenja të ndonjë krize institucionale apo të koalicionit qeverisës. Edhe pse opozita

deklarativisht po thekson nevojën e mbajtjes së zgjedhjeve të reja, ajo nuk është e gatshme të hyjë në zgjedhje, sepse ka zgjedhje të brendshme dhe ka pasur qarje brenda subjekteve politike. Prandaj, duke e pasur një opozitë të çakorduar, nuk është koha për zgjedhje të parakohshme", është shprehur Isufi.

"Epoka e re": Z. Isufi, si po funksionon koalicioni qeverisës sepse, për shkak të dallimeve të partnerëve rreth vendimit për taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës, është krijuar përshtypja se nuk është duke shkuar si duhet koalicioni?

Isufi: Koalicioni qeverisës është duke funksionuar mirë, megjithëse ka dallime rreth taksës prej 100 për qind ndaj mallrave të Serbisë. Siç dihet, vendimin për taksën e ka marrë Qeveria dhe është në dorë të saj dhe kryeministrit Haradinaj që të vendosë për këtë çështje.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 31 MARS - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka bërë me dije se koalicioni qeverisës është funksional dhe po i kryen obligimet që ka marrë. Ai ka thënë se brenda koalicionit ka vetëm mendime të ndryshme për çështje të caktuar dhe nuk

ka ndonjë krizë e cila mund ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Isufi ka deklaruar se këto dallime ndërmjet partnerëve mund të tejkalohen. "Ndonjëherë ka nuanca të mendimeve të partnerëve politikë, sepse për këtë arsye ne funksionojmë si parti politike. Megjithatë, konsiderojmë se koalicioni qeverisës

është funksional dhe po vazhdon bashkëpunimin në mes të liderëve për shkak të përgjegjëseve të përbashkëta shtetërore që kanë. Prandaj, ndonjë dallim eventual që mund të jetë, nuk do të thotë se është zbehje e raporteve të funksionimit në mes të partnerëve qeverisës", ka thënë Isufi.

Ai ka vlerësuar se ajo që i bashkon liderët e koalicionit qeverisës është interesi

jedhje të reja

vendimet që janë marrë në këtë qeveri, normalisht se kanë ndikuar që të forcohet bashkëpunimi ndërmjet partnerëve të koalicionit qeverisës.

"Epoka e re": Por që një kohë nuk janë parë bashkë në ndonjë aktivitetet Kadri Veseli dhe Ramush Haradinaj. A mund të thuhet sa ka ftohje të raporteve mes tyre?

Isufi: Ndonjëherë ka nuanca të mendimeve të partnerëve politikë, sepse për këtë arsye ne funksionojmë si parti politike. Megjithatë, konsiderojmë se koalicioni qeverisës është funksional dhe po vazhdon bashkëpunimi mes liderëve për shkak të përgjegjëseve të përbashkëta shtetërore që kanë. Prandaj, ndonjë dallim eventual që mund të jetë, nuk do të thotë se është zbehje e raporteve të funksionimit në mes të partnerëve qeverisës.

"Epoka e re": A mund të tejkalohen këto dallime në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës?

Isufi: Këto dallime në ndonjë çështje në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës mund të kalohen duke komunikuar në mënyrë institucionale liderët politikë. Meqenëse kemi të bëjmë me çështje kapitale për vendin, atëherë duhet të ketë më shumë komunikim të brendshëm në mënyrë që të mos reflektojnë në opinion mendimet e tilla kundërthënëse.

"Epoka e re": Këto ftohje të raporteve në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës, opozita dhe njohësit e rrethanave politike në vend po i shohin si mundësi për të shkuar në zgjedhje të parakohshme?

Isufi: Opozita e ka për obligim ta korrigjojë qeverinë, pra t'i gjejë gabimet e saj dhe ta kritikojë atë. Por, njëherë përnjëherë nuk ka shenja të ndonjë krize institucionale apo të koalicionit qeverisës. Edhe pse opozita deklarativisht po thekson nevojën e mbajtjes së zgjedhjeve të reja, ajo nuk është e gatshme të hyjë në zgjedhje, sepse ka zgjedhje të brendshme dhe ka pasur qarje brenda subjekteve politike. Prandaj, duke e pasur një opozitë të çakorduar, nuk është koha për zgjedhje të parakohshme.

"Epoka e re": Pra, jeni të bindur se këtë verë nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme?

Isufi: Sipas dinamikës që është duke vazhduar, nuk shihet interesim për zgjedhje të parakohshme as nga ata që po kërkojnë.

SBASHK-u këmbëngul: S'do të ketë kompensim të orëve

"SBASHK-u njofton prindërit dhe nxënësit, edhe opinionin, se mësimdhënësit, pavarësisht a janë në vendin e punës a jo, zhvillim të procesit mësimor për t'i zëvendësuar ditët e humbura të grevës nuk do të ketë. Nuk është mirë të krijohen tensione shtesë, sepse edhe kështu mësimdhënësit e Kosovës janë tepër të revoltuar", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 MARS - Me qëllim që të njoftohet edhe një herë opinionin, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) ka përsëritur se nuk ka zëvendësim të orëve të humbura as gjatë pushimit pranveror dhe as në fundjavë. Sindikata ka bërë me dije se pushimi pranveror nga data 1 deri më 5 prill do të fillojë sipas kalendarit shkollor 2018-2019. Sipas SBASHK-ut, gjatë dy ditëve të fundit është tentuar të krijohet një paqartësi nga ndonjë këshill i prindërve, duke u bërë thirrje prindërve t'i dërgojnë fëmijët në shkollë pasi që mësimdhënësit qenkan në shkollë. "SBASHK-u njofton prindërit dhe nxënësit, por edhe opinionin, se mësimdhënësit, pavarësisht a janë në vendin e punës a jo, zhvillim të procesit mësimor për t'i zëvendësuar ditët e humbura

të grevës nuk do të ketë. Nuk është mirë të krijohen tensione shtesë, sepse edhe kështu mësimdhënësit e Kosovës janë tepër të revoltuar, sidomos pas fyerjeve që u bënë nga dy deputetët e Kuvendit të Kosovës ditën e enjte, në seancën e jashtëzakonshme dhe aq më shumë pse prindërit nuk reagon në mbrojtje të mësimdhënësve të fëmijëve të tyre", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut.

SBASHK-u për të hënë ka ftuar kryesinë dhe kryetarët e sindikatave komunale të arsimit parauniversitar të të gjitha komunave me qëllim që të analizojë se si është situata gjatë pushimit pranveror dhe nëse ka presione ndaj anëtarësisë. Varësisht nga informatat që merr, SBASHK-u ka theksuar se do të marrë veprime sindikale, duke mos përjashtuar edhe shpalljen e grevës në komunat ku ka presione, e nëse presione do të ketë në shumicën e

komunave, do të shkohet në grevë të përgjithshme në nivel vendi. "I ftoj mësimdhënësit nëse nesër, eventualisht bëhet presion përmes nxënësve, me tentim që të hyjnë në klasa, gjoja për të zhvilluar mësim, në ato çaste mësimdhënësit le t'i lëshojnë objektet shkollore në shenjë proteste", është theksuar më tutje në njoftimin e SBASHK-ut.

SBASHK-u ka ftuar kryetarët e komunave të Kosovës të bisedojnë me drejtorët e DKA-ve për t'i lënë të qetë mësimdhënësit dhe mos të ushtrjnë presione për zbatimin e vendimit të ministrit Bytyqi deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. "Gjithashtu, falënderojmë disa kryetarë të komunave që kanë mirëkuptuar kërkesat e SBASHK-ut. Nxënësve u dëshmojmë pushime të mira pranverore nga data 1 deri më 5 prill 2019", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut.



"Epoka e re": Mendoni se duhet të mbetet edhe më tutje taksa përkundër kërkesës së partnerëve të koalicionit dhe partnerëve ndërkombëtarë për ta suspenduar atë?

Isufi: Taksa ndaj produkteve të Serbisë do të vazhdojë të qëndrojë derisa Serbia të mos e ndalë ofensivën diplomatike ndaj shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, si dhe derisa Serbia t'i ndalë ndërhyrjet në territorin e Kosovës, duke manipuluar me popullatën serbe këtu.

"Epoka e re": Mospajtimet e partnerëve të koalicionit qeverisës për këtë çështje, mund të ndikojnë në punën e qeverisë?

Isufi: Kjo nuk e pengon angazhimin e përbashkët të partive politike në koalicionin qeverisës. Ka tema që ndërliken me zbatimin e programit qeverisës që në një farë forme e bën homogjene qeverisjen. Dhe

Mbi 700 vjedhje për dy muaj në Kosovë

Zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë bërë me dije se në dymujorin e parë të këtij viti janë evidentuar mbi 700 raste të vjedhjeve. Rajonet ku kanë ndodhur këto raste të vjedhjeve më shumë janë qendrat më të mëdha ndërsa si qytet, dukshëm më shumë raste kanë ndodhur në Prishtinë

PRISHTINË, 31 MARS - Gjatë vitit 2018 Policia e Kosovës ka evidentuar mbi pesë mijë raste të vjedhjeve të cilat kanë ndodhur në pronat e qytetarëve, qofshin ato në shtëpi banimi, dyqane apo vetura. Derisa vetëm në dymujorin e parë të këtij viti janë evidentuar mbi 700 raste të vjedhjeve, rajonet ku kanë ndodhur këto raste të vjedhjeve, sipas Policisë Kosovës, më shumë janë

qendrat më të mëdha, derisa si qytet, dukshëm më shumë raste kanë ndodhur në Prishtinë. Policia e Kosovës gjatë vitit 2018, nën dyshimin për përfshirje në veprimtari të ndaluara, ka arrestuar 15 481 të dyshuar. Zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Daut Hoxha, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se rastet e vjedhjeve kanë shënuar rënie përgjatë viteve, megjithatë

mbetet shqetësuese si dukuri. Hoxha shton se Policia e Kosovës ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë edhe sjelljen e kryesve të këtyre akteve të vjedhjes para organeve të drejtësisë. "Në Kosovë, sikundër edhe në vendet e tjera, ndodhin akte të ndryshme, kryhen aktivitete të ndryshme penale. Kështu gjatë vitit 2018 janë evidentuar mbi pesë mijë vjedhje. Për këtë vit, duke iu referuar të dhënave në sistemin informativ të Policisë për dymujorin e parë në nivel të Kosovës, janë evidentuar 724 vjedhje të kryera, 74 në tentativë. Këto akte nuk është e mundur të zhduken, nuk ka asnjë vend në jetën bashkëkohore që ka eliminuar në tërësi kriminalitetin. Policia e Kosovës

me aktivitete synon reduktimin e secilës prej këtyre veprimtarive të paligjshme. Krahasuar me periudhën e viteve 2013-2015, me trevjeçarin 2016-2018, vjedhjet kanë shënuar ulje për 21 për qind", ka deklaruar Hoxha. Në fund të dhjetorit të vitit të kaluar një polic ishte vrarë në detyrë përderisa po përpiqej të kapte një të dyshuar për grabitje në një bankë në qytetin e Istogut, ku më pas i vrarë mbeti edhe personi i dyshuar për plaçkitje. Ndërkaq, në fillim të këtij viti, në periferi të Prishtinës, policia kishte konfirmuar se një person kishte mbetur i vrarë përderisa po përpiqej të plaçkiste një shtëpi private. Avni Islami, ekspert i fushës së sigurisë, ka thënë për "Radion

Evropa e Lirë" se janë mjaft shqetësuese rastet e vjedhjeve në formë të armatosur. Ai thotë se kjo formë e vjedhjes ka shënuar rritje në Kosovë. "Vjedhjet në Kosovë si fenomen, me theks të veçantë u bënë në vitin që lamë pas, por edhe këtë vit, pavarësisht me një trend më të ulët, por mënyra e kryerjes së tyre me atë të armëve të zjarrit po karakterizohet, e që kjo formë e vjedhjeve nuk ka qenë më parë në këtë nivel. Pra, pavarësisht prej numrit të rënies së vjedhjeve, rrezikshmëria e grupeve të armatosura që po kryejnë vjedhje apo plaçkitje me armë të zjarrit po vazhdon dhe kjo është shqetësuese për qytetarët", ka theksuar ai.

Për qytetarët vjedhjet janë bërë një dukuri shqetësuese në lagjet ku ata jetojnë. Dardan Sylaj, qytetar, i cili banon në një lagje të Prishtinës, thotë se nuk ndihet edhe aq i sigurt. "Po, ka pasur disa raste në lagjen time kur janë kryer vjedhje nga persona të cilët asnjëherë nuk janë identifikuar nga policia. Të frikëson ky fakt kur dëgjon se fqinjët i është thyer banesa apo lokali dhe i janë vjedhur gjërat. Mua nuk më ka ndodhur një gjë e tillë, por më frikëson sa herë që e mbyll banesën dhe shkoj në punë apo diku tjetër", është shprehur ai. Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, vjedhje klasifikohet vepra kur një personi tjetër i merret pasuria, e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë eurosh e më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër. Personat që kryejnë vjedhje apo grabitje me përdorim të forcës apo kanosje serioze për personin tjetër, me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme, dënohen me burgim nga tre deri në 12 vjet.



Tahiri: Administrata shtetërore, shpirti i reformës ligjore

Prishtinë, 31 mars (ER) - Në ceremoninë përmbyllëse të programit për zhvillimin e lidershit transformues të zbatuar nga RIT Kosova (A.U.K) dhe mbështetur nga USAID, koordinatori nacional për reforma shtetërore, Besnik Tahiri, ka prezantuar ndikimin e këtij programi në shërbim të zhvillimit të kuadrit të udhëheqësve institucionalë në fushat e zhvillimit ekonomik, politik dhe social. Me këtë rast, ai ka pohuar se ky program ka sjellë dije dhe përvojë të re për institucionet në fushën e politikave publike që, sipas tij, në procesin e reformës është synim i përbashkët që adminis-

trata shtetërore të kthehet në promotor të zhvillimit. Në urimin për të gjitha gjeneratat që kanë ndjekur këtë program, Besnik Tahiri ka thënë se shpirti i shtetit qëndron tek administrata publike, pasi kjo është kujtesë dhe vazhdimësi institucionale. "Kjo ceremoni vjen në një çast kyç për reformat e ndërmarra në administratën shtetërore dhe strukturën e Qeverisë. Pra, pavarësisht prej përpjekjeve për reformë të politikave dhe legjislacionit, kapacitetet për zbatim dhe ndjekja e trendëve nëpërmjet digjitalizimit janë hapa të domosdoshëm që duhet ta pasojnë këtë reformë", ka thënë Tahiri.



Limaj në përvjetorin e masakrës së Burimit bën thirrje për zbardhjen e krimeve serbe në Kosovë

Me rastin e 20-vjetorit të masakrës së Burimit në Malishevë, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka bërë thirrje për institucionet e drejtësisë që ta hetojnë secilën masakër që është kryer në Kosovë. Ai ka thënë se liria ka kuptim vetëm kur kryerësit e këtyre krimeve ta marrin dënimin e merituar

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

MALISHEVË, 31 MARS - Të dielën në fshatin Burim të Malishevës është mbajtur tubim përkujtimor me rastin e 20-vjetorit të masakrës së Burimit. Në këtë masakër 20 vjet më parë forcat paramilitare serbe masakruan 34 civilë të pafajshëm, në mesin e tyre fëmije e pleq. Me këtë rast është vendosur edhe gurthemeli i Kompleksit Memorial. Në këtë tubim përkujtimor ka marrë pjesë edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, i cili ka thënë se monumenti i vendosur sot tregon se "ne

kujtojmë dhe nderojmë të kaluarën tonë".

Limaj ka thënë se monumenti u duhet të gjallëve për ta kujtuar sa e shtrenjtë ishte liria të cilën sot e gëzojmë. "Liria kalon nëpër sfida dhe dhimbje, por përfundon me krenari. Këtë ditë e kujtojmë me trishtim dhe dhimbje, por në fund nga ky tubim dalim me krenari dhe kjo e bën dallimin. Nuk ka vdekje për liri e cila nuk ka histori mbrapa. Prandaj edhe ushqehet liria dhe gjithmonë ka djem e vajza që janë të gatshëm ta sakrifikojnë jetën për liri. Sot ne kujtojmë pleqtë dhe fëmijët të cilët sakrifikuan për lirinë. Ata nga qielli na ftojnë që ne të gjal-



lët të punojmë që të mos ndalemi deri të gjenden kryerësit e këtyre krimeve dhe ta marrin dënimin e merituar", ka thënë Limaj. Ai u ka bërë thirrje institucioneve të drejtësisë ta hetojnë secilën masakër të kryer nga forcat serbe në Kosovë. "Duhet të përgatiten dosjet për secilën vrasje që ka ndodhur dhe ato të shërbejnë për t'i ndjekur kryerësit e këtyre krimeve anekënd Kosovës. Vetëm atëherë liria ka kuptim", ka theksuar Limaj. Më tutje, Limaj ka thënë se shenjat tona të lirisë duhet të na shërbejnë për të mos u habitur se ku kemi qenë e ku jemi. "Para 20 vjetëve kombi ynë kishte ballafaqimin përfundimtar me regjimin kriminal serb. Masakrat

që kryheshin në Kosovë ishin shenjat përfundimtare se pushteti okupator po i numëronte ditët e fundit dhe në ato kohë nuk zgjidhte mjet e njerëz", ka shtuar Limaj. Ai ka thënë se liria ushqehet çdo ditë. "Sot lirinë të cilën e gëzojmë askush nuk na ka falur. Dëshmia më e mirë është masakra e Burimit. Lavdi e respekt të gjithë martirëve që ranë për lirinë e Kosovës! Lavdi të gjithë dëshmorëve të Llapushes dhe krejt Kosovës! Nder dhe respekt për të gjitha familjet e martirëve dhe dëshmorëve të Kosovës", ka përfunduar Limaj. Ragip Begaj, kryetar i Komunitetit të Malishevës, ka thënë se sot

janë mbledhur për ta përkujtuar ngjarjen më të rëndë të Komunitetit të Malishevës. "Këtu u vranë dhe u masakruan dhjetëra civilë të pafajshëm. Pikërisht në këtë vend njësitë paramilitare vranë 34 persona si dhe tetë persona të tjerë janë vrarë përreth Burimit, po më 31 mars të vitit 1999. Edhe sot, pas 20 vjetëve, e kujtojmë këtë ngjarje, pasi ishte masakra më e madhe në komunën tonë", ka thënë Begaj. Në emër të familjeve të martirëve të masakrës së Burimit, Adem Morina ka kërkuar që kjo masakër të sensibilizohet edhe më shumë, duke bërë thirrje që kryerësit e kësaj masakre të dalin para drejtësisë.



Sejdiu: Vendosja e flamurit të shtetit të origjinës në produkte, ndër punët e mira të PSD-së

PRISHTINË, 31 MARS (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Sejdiu, ka thënë të dielën se një ndër punët e mira që kanë bërë deputetët e kësaj partie është futja e një neni në Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, ku kërkohet vendosja e flamurit të shtetit të

originës së produktit bashkë me çmim. "Një nga punët që kemi bërë në Kuvend është edhe futja e një neni në Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, ku kërkohet vendosja e flamurit të shtetit të originës së produktit bashkë me çmim. Sot në pikat e shitjes gjithandej Kosovës mund të

vendosni në mes të prodhimeve vendore, e kështu ta ndihmoni punësimin dhe ekonominë e vendit, apo edhe të vazhdohet konsumi i produkteve të tjera. Vendimi është individual, por përfitimet mund të jenë kolektive. Dua je tënden", ka shkruar Sejdiu në llogarinë e vet në "Facebook".

Rahoveci përkujton 106 martirët e masakrës së Pastaselit

RAHOVEC, 31 MARS - Kryetari i Komunitetit të Rahovecit, Smajl Latifi, ka përkujtuar të dielën 106 martirët të cilët kanë humbur jetën në masakrën e fshatit Pastasel të kësaj komune. Latifi në tubimin përkujtimor në

nderim të të rënëve ka thënë se gjaku i atyre që u martirizuan është themel i lirisë sonë. "Forca të panumërta serbe, me gjithë kapacitetin ushtarak, 20 vjet më parë, më 31 mars 1999, rrethuan fshatin Pastasel dhe

ekzekutuan mizorisht 106 shqiptarë të paarmatosur, burra, gra, pleq dhe fëmijë. Fatkeqësisht, deri më sot lëre që nuk u dënua dikush, por askush nga kriminelët serbë as nuk u hetua për këto krime të

llahtarshme. Kujtimet e këtyre ngjarjeve të rënda në komunën tonë i kemi ende të freskëta dhe plagët janë të hapura, kurse gjaku i atyre që u martirizuan është themeli i lirisë sonë!", ka thënë Latifi.



Vetëm 12.7 për qind e femrave të punës

Sipas raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e punësimit e femrave është 12.7 për qind. Kjo shifër është vlerësuar alarmante nga përfaqësues të Odës së Afarizmit të Kosovës, të Grupit të Grave Deputete, të Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKCAK) dhe të Dhomës Ekonomike të Grave. Mentaliteti patriarkal, infrastruktura jo e favorshme ligjore për pushimin e lehonisë dhe niveli i arsimit të gjeneratave të kaluara, janë konsideruar faktorët që po ndikojnë në çështjen e punësimit të femrave



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 31 MARS - Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e katërt (TM4) 2018, të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë është 31.4 për qind, ndërsa punësimi më i lartë është te meshkujt (45.2 për qind), kurse punësimi te femrat është 12.7 për qind. Ndonëse sipas nenit 7 të Projektligjit për Pushimin e Lehonisë dhe Pushimin Prindëror "Tre muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim prej shtatëdhjetë përlindësh (70 për qind) të pagës bazë, në gjashtë (6) muajt në vijim pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim prej pesëdhjetë përqindësh (50 për qind) të pagës mesatare në Kosovë. Gruaja e punësuar ka

të drejtë, sipas këtij ligji, që ta zgjasë pushimin e lehonisë edhe për tre (3) muaj të tjerë pa pagesë".

Ky nen është kundërshtuar nga kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Skënder Krasniqi. Ai ka thënë se ky projektligj është kundër femrës dhe ka kërkuar që, sikurse në vendet e rajonit, pushimin e lehonisë ta paguajë në tërësi qeveria. Krasniqi ka deklaruar se është alarmante shkalla e papunësisë së femrave, duke kërkuar që shteti i Kosovës të jetë syhapur në këtë drejtim. Ai ka thënë se arsyeja kryesore është gjendja jo e mirë financiare e sektorit privat dhe mospasja mundësi për pagesën e pushimit të lehonisë që, sipas tij, ndikon që femrat të jenë të privuar nga puna. "Arsyeja kryesore e papunësisë së femrave është gjendja jo e mirë që shteti është duke e praktikuar ndaj institucioneve private. Në

të gjitha shtetet e rajonit shteti merr përsipër pushimin e lehonisë me 100 për qind deri në 12 muaj të pagës, ndërsa në Kosovë gjashtë muaj e detyron biznesin për të paguar 70 për qind të pagës, kurse tre muaj e paguan 50 për qind të pagës

mesatare të Kosovës. Realisht kjo e dënon femrën. Propozimi i ri i Ministrisë së Punës është që tre muaj 70 për qind të pagës ta paguajë biznesi, ndërsa gjashtë muaj 50 për qind të pagës mesatare prapë shteti. Kjo sërish është kundër femrës. Të marrësh pagë 200 euro është e paarrtshme për të mbijetuar. OAK-u ka kërkuar nga kryeministri Haradinaj dhe ministri Reçica, por edhe nga i gjithë parlamenti, që ta marrin përsipër këtë për faktin se nuk është barrë e rëndë shumë për shtetin", ka thënë Krasniqi, duke theksuar se udhëheqësit nuk e kanë problem për t'ia rritur pagat vetes, por kur është në pyetje kjo çështje që afekton në rritje të punësimit dhe përkrahje të biznesit, çdoherë po llogaritet buxheti, duke potencuar "se nuk kanë buxhet". "Ku po e marrin buxhetin që po ia rrisin pagat vetes. Le ta lënë luksin dhe të mendojnë për të mirën e qytetarëve. Prej 600 mijë femrave që janë në moshë pune, sipas ASK-së, vetëm 12.7 për qind janë të punësuar dhe 87.3 për qind e tyre janë të papuna. Mos të harrojmë se Kosova ka rënie drastike të lindjeve", ka thënë Krasniqi. Kryetarja e Grupit të Grave Deputete, Mexhide Mjaku-Topalli, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se, ndonëse prej vitësh diskutohet kjo problematikë, ende nuk kanë arritur në një zgjidhje adekuate. Ajo shpreson se me shkuarjen e draftligjit për lehonitë në Kuvendin e Kosovës do t'i japin zgjidhje kësaj çështje. "Prej

vitesh diskutohet çështja e papunësisë së femrave, kjo është shqetësuese për të gjithë qytetarët e Kosovës, sidomos për ne si gra deputete. Unë si kryetare e Grupit të Grave Deputete gjithherë kam qenë në tryezat që janë mbajtur për këtë temë ku janë paraqitur raportet e mbledhura për përqindjen e grave të papuna. Mirëpo në qoftë se u referohemi kualifikimeve, shumë më shumë dalin se vajzat dhe gratë janë të kualifikuara", ka thënë Mjaku-Topalli, duke shtuar se është kërkuar që të plotësohet dhe të ndryshohet Ligji i lehonisë. "Ashtu sa kam informatë unë, në Ligjin e Punës nuk figuron pushimi i lehonisë dhe është duke u hartuar një draft-koncept i veçantë për Ligjin e lehonisë, i cili në muajin qershor do të jetë në Kuvend", ka thënë Mjaku-Topalli. Ajo ka thënë se duhet t'u krijohen kushte të barabarta grave, si atyre në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat. "Gjithashtu, kemi informata nga shoqëria civile se femrat që gjatë marrjes në pyetje për aplikim në një vend pune ka pasur edhe diskriminim, pasi janë pyetur për statusin e tyre. Meqë është barrë për kompanitë dhe institucionet private që t'i paguajnë dy paga për një të punësuar, atëherë është menduar të propozohet Ligji i lehonisë, që ai të plotësohet dhe ndryshohet në mënyrë që mos të diskriminohen femrat", u shpreh ajo. Ndërkaq sa i përket shifrës së Ministrisë së Administratës

Reçica në Ferizaj fton bizneset dhe punëkërkuessit ta vizitojnë Panairin e Punës

FERIZAJ, 31 MARS (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me GIZ-in gjerman, kanë hapur në fundjavë Panairin e Punës edhe në Ferizaj. Ministri i MPMS-së, Skender Reçica, u ka bërë thirrje bizne-

seve ta vizitojnë panairin për ta gjetur fuqinë punëtore që u nevojitet si dhe punëkërkuessve që të vijnë e t'i prezantojnë shkathtësitë e tyre dhe të përfitojnë nga mundësia për t'u bërë pjesë e tregut të punës. Ministri Reçica u bëri thirrje

sidomos të rinjve dhe grave, që t'i vizitojnë zyrat e punësimit për të përfituar nga mundësitë në kuadër të masave aktive të tregut të punës si dhe qendrat e aftësimin profesional të trajnohen në një mori profilesh që ofrohen aty.



suara, kërkohet përkrahje nga qeveria

Bunjaku përmend faktorët që po ndikojnë në dekurajimin e femrave për tregun e punës

Drejtoresha në Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKCAK), njëherësh anëtare e Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës, Ardiana Bunjaku, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se mentaliteti patriarkal, infrastruktura e pafavorshme për pushimin e lehonisë dhe niveli i arsimimit për gjeneratat e kaluara, janë faktorë të pozitës disfavorizuese për femrat në tregun e punës. "E para dhe më e rëndësishmja është fakti se ne ende jetojmë në një shoqëri patriarkale në të cilën përgjegjësitë për familjen, kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve e kanë gratë. Pastaj një faktor tjetër janë ligjet të cilat janë përpjekur t'i mbrojnë gratë, por kanë arritur një efekt të kundërt. Shembull, pushimi i lehonisë është më i gjatë në Kosovë në krahasim me vendet e tjera dhe kostoja financiare

për ta mbuluar këtë pushim kryesisht mbulohet nga punëdhënësit, gjë që dekurajon punësimin e grave në kompanitë private", ka thënë Bunjaku, duke shtuar se faktori tjetër ka të bëjë me nivelin e arsimit të grave, përjashtuar gjeneratat e reja. "Gratë në Kosovë janë më pak të arsimuara, duke përjashtuar gjeneratat e reja. Sipas statistikave të Bankës Botërore, 50 për qind e grave në moshë punësimi kanë arsimim të mesëm ose të ulët krahasuar me burrat që janë vetëm 27 për qind. Gjithashtu, gratë kanë gjasë më të vogël të kyçen ose rikthehen në punë pas pushimit të lehonisë për shkak të humbjes së hapit me aftësitë dhe përvojën e punës", u shpreh ajo.

Sa i përket të dhënave të Ministrisë së Administratës Publike, se 92 për qind e posteve të larta në institucionet

publike i udhëheq gjinia mashkullore, Bunjaku ka deklaruar se, edhe pse jo të gjitha çështjet duhet t'u atribuohen ligjeve, duhet pasur inkurajim për vendimmarrjen e grave. "Edhe pse mendoj se jo të gjitha çështjet mund të rregullohen me ligje, në rastin e punësimin të grave në institucionet publike, në mënyrë që të ndërrohet kultura se vetëm burrat dinë të bëjnë punët si duhet, të ketë ligje që i vendosin gratë në pozitë të barabartë me burrat. Do të thotë, nëse aplikuesi i plotëson të gjitha kriteret si nga aspekti i arsimimit, përvojës etj, të favorizohet gjinia femërore. Dua të theksoj se inkurajimi i femrës jo vetëm për punësim, por në të gjitha aspektet e jetës duhet të fillojë nga familja si dhe shoqëria në përgjithësi, veçanërisht nga guximi i saj për të arritur atë që synon", ka deklaruar Bunjaku.

Publike, se 92 për qind e posteve të larta në institucionet publike i udhëheq gjinia mashkullore, Mjaku-Topalli është përgjigjur: "Ne si gra deputete jemi bërë bashkë me shoqërinë civile dhe jemi duke punuar në këtë drejtim. Kur dalim jashtë vendeve, u referohemi ligjeve që i kemi, por që në realitet ligjet po hasin në moszbatim. Jemi duke punuar që kodi zgjedhor të ndryshohet dhe të jetë në harmonizim me barazinë. Kjo është padrejtësi

që po i bëhet femrës, pasi çdoherë thuhet se 'kemi për të vendosur në këtë pozitë grua'. Po shpresoj se do të shënojmë hapa pozitivë në këtë drejtim", ka deklaruar Mjaku-Topalli. Deputetja e Nismës Socialdemokrate, anëtare e Bordit të Grupit të Grave Deputete, Albulena Balaj-Halimaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se përderisa në gjeneratat e kaluara 80 për qind nga që kanë studiuar

ishin burra dhe vetëm 20 për qind gra, kjo edhe është arsyeja që jep një minus sa i përket shkallës së punësimin te femrat. "Sigurisht se bizneset private hezitojnë t'i marrin gratë në punë, pasi në momentin që ajo del në pushimin e lehonisë, bizneset janë të detyruara, sipas ligjeve në fuqi, të paguajnë për pushimin e lehonisë dhe kjo i

kushton plus një punëtor që ta zëvendësojë pushimin e lehonisë. Këto janë dy arsytet pse na japin këtë normë të papunësisë te femrat në Kosovë", ka thënë Balaj-Halimaj. Ajo ka theksuar se çdo iniciativë që ka të bëjë me pushimin e lehonisë dhe gratë do ta mbështesë. "Ministri Reçica ka filluar të punojë për një projektligj që lehonat e

papuna të paguhen nga buxheti i shtetit të Kosovës. Shumë kjo që do të jetë simbolike prej 100 eurosh në muaj dhe, po ashtu, do të paguhen edhe ato që nuk punojnë për gjashtë muaj. Çdo iniciativë që ka të bëjë me gratë dhe pushimin e lehonisë unë jam e gatshme ta mbështes me çdo forcë që kam", është shprehur deputetja Balaj-Halimaj.

BQK-ja organizoi ligjëratë për tregun e letrave me vlerë

PRISHTINË, 31 MARS (ER) - Studentët e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB kanë mësuar për mënyrën e funksionimit të tregut të letrave me vlerë në Kosovë. Shkendije Nahi nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ka prezantuar para studentëve, në kuadër të 'Javës Ndërkombëtare të Parasë' në funksion të edukimit financiar, mënyrën e organizimit dhe mbajtjes së ankandeve të letrave me vlerë dhe për rolin e BQK-së në këtë proces. "Sipas Rregullores për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë, instrumentet e borxhit në tregun e Letrave me Vlerë janë: Bonot e Thesarit - Instrumente afatshkurtra,

Obligacionet - Instrumente afatgjata, Operacionet e tregut sekondar (Tregtimi, Repo-t). Dy operacionet kryesore Repo janë: Repo me BQK (Vertikale) dhe Repo në mes bankave (Akteve Primar) (Horizontale)", ka deklaruar Nahi në këtë ligjëratë. Burim shtesë dhe i rëndësishëm për mobilizimin e mjeteve financiare janë edhe mundësitë për investime në instrumente likuide, investime të sigurta dhe rritja e likuiditetit në tregun monetar. Studentët kanë marrë informata se cilat institucione financiare janë pjesëmarrëse në Tregun Primar të Letrave me Vlerë dhe në Tregun Sekondar të Letrave me Vlerë, pastaj kanë marrë informata të tjera. Nga ana tjetër, profesoresha e



lëndës Institucionet Ndërkombëtare Financiare, Florije Miftari, ka thënë se organizimi i ligjëratave nga

BQK-ja për studentët e drejtim-it të Ekonomisë do të ketë një ndikim të mirë në mësim-nxënie. Studentët e pranishëm

kanë parashtruar pyetje të ndryshme rreth mënyrës së funksionimit të tregut të letrave me vlerë.

Muharremaj zotohet për zbatimin e projekteve në funksion të zhvillimit ekonomik

SUHAREKË, 31 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, është takuar me banorët e Budakovës, me të cilët ka biseduar për projektet të cilat do të realizohen në këtë lokalitet gjatë viteve të ardhshme. Ai ka thënë se do ta angazhohet maksimalisht për zbatimin e

projekteve të cilat kanë për qëllim zhvillimin ekonomik të Suharekës. "Edhe në Budakovë diskutuam gjerësisht mbi projektet që do të zbatohen për vitet e ardhshme. Angazhimi institucional do të vazhdojë mbi zbatimin e projekteve për zhvillim ekonomik", ka deklaruar Muharremaj.



Lulzim Sadiku zgjedhet kryetar i PDK-së në Obiliq, kurse Adem Morina në Has të Prizrenit

OBILIQ, 31 MARS (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka përmbyllur zgjedhjet e brendshme në degët e Obiliqit dhe në Has të Prizrenit, ku me shumicë të votave të delegatëve, kryetar i degës së kësaj partie në Obiliq është zgjedhur Lulzim Sadiku, ndërsa në Has të Prizrenit kryetar është zgjedhur Adem Morina. Kuvendi i Degës së PDK-së në Obiliq ka zgjedhur edhe Këshillin Drejtues me 35 anëtarë si dhe pesë delegatët për Kuvendin e Përgjithshëm Zgjedhor, i cili do të kulmojë me zgjedhjen e strukturave të reja të PDK-së për jetësimin e platformës Dekada e Re.

Punimet e Kuvendit Zgjedhor të Degës së PDK-së në Obiliq, në emër të kryetarit Kadri Veseli, i ka përshëndetur nënkryetari i partisë, Bajrush Xhemajli, i cili ka thënë se procesi zgjedhor në PDK rikonfirmon fuqinë politike të partisë më të madhe në vend, e cila, sipas tij, në këtë proces po reformohet dhe fuqizohet

edhe më shumë për Dekadën e Re.

Ndërsa Kuvendi Zgjedhor i Degës në Has të Prizrenit ka zgjedhur edhe Këshillin Drejtues prej 40 anëtarësh dhe delegatët për konventën qendrore. Të pranishmit fillimisht i ka përshëndetur kryetari i deritashëm i kësaj dege, Nezir Çoçaj, i cili ka prezantuar të arriturat e degës dhe fitoret e njëpasnjëshme në mes të dy kuvendeve. Ndërkaq, Betim Gjoshi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në PDK ka thënë se platforma Dekada e Re do të shtrihet në secilën lagje të Kosovës dhe po merr mbështetje nga të gjithë qytetarët.

Platforma e PDK-së, Dekada e Re dhe vizioni i liderit, Kadri Veseli, ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm, ofrimin e hapësirës për kuadro të reja të cilat do të jenë në shërbim të ndërmarrësisë, ideve novatore të qytetarëve brenda vlerave integrale, me besim dhe zhvillim.



Lladrovci, ish-kongresistit Weller: Jemi të bekuar me miqësinë amerikane

DRENAS, 31 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, gjatë fundjavës kishte një mysafir të veçantë, ish-kongresistit Jerry Weller, të cilin e ka pritur në shtëpi për drekë. Lladrovci ka theksuar se gjatë kësaj vizite të Wellerit kishte rast të fliste për historinë tonë të re, për ecurinë e zhvillimit komunal si dhe synimet për zhvillim të mëtejshëm. Po ashtu, ai ka theksuar se me kënaqësi, pranë bustit të Skënderbeut, ia ka dhuruar Wellerit librin për Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin të

autorit Bedri Islami. "Kam qenë i nderuar për të pritur mysafir për drekë në shtëpi, ish-kongresistin Jerry Weller, pjesë e Kongresit Amerikan, 1995-2009, me bashkëpunëtorë. Gjatë kësaj vizite ishte rasti të flasim për historinë tonë të re, për ecurinë e zhvillimit tonë komunal si dhe për synimet tona për zhvillim të mëtejshëm. Gjatë këtij qëndrimi dhe njohjeje me mikun tonë, theksova se jemi të bekuar me miqësinë amerikane që nga presidenti Wilson deri në ditët e sotme.

Sot, ne, jemi të nderuar me orientimin e fuqishëm të miqve amerikanë, për fuqizimin e shtetësisë së vendit tonë", ka shkruar Lladrovci në llogarinë e vet në "Facebook".

Po ashtu, Lladrovci ka bërë me dije se në këtë takim ka theksuar potencialin e kësaj komune për zhvillimin në bujqësi, qendrën e re të biznesit për kompanitë e interesuara, si dhe energjinë e ripërtërishme. "Ne ofrojmë mundësi maksimale për biznesin, në veçanti bizneset e miqve tanë", ka thënë ai.



Komuna e Deçanit shpall 'Qytetar nderi' gjeneralin amerikan John C. Boyd

DEÇAN, 31 MARS (ER) - Kuvendi Komunal i Deçanit ka nderuar John C. Boyd, gjeneralin amerikan, me titullin "Qytetar nderi" i kësaj komune. Ky nderim ushtarakut amerikan i është bërë në shenjë mirënjohjeje për kontributin e dhënë në luftën e Kosovës, për mbështetjen dhe fuqizimin e shtetësisë së saj dhe për përkrahjen e Kosovës në integritet euroatlantike.

Dorëzimi i këtij vendimi gjeneralit amerikan i është bërë në një ceremoni të veçantë, ku i pranishëm ishte edhe kryeministri Ramush Haradinaj, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant

Rrahman Rama, deputetë të Kuvendit të Kosovës, si dhe përfaqësues të tjerë nga qeveria qendrore dhe lokale.

Kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka shprehur mirënjohjeje për të gjithë ushtarakët e ShBA-së dhe NATO-s, të cilët, sipas tij, promovojnë paqen dhe garantojnë sigurinë botërore.

Pas pranimit të vendimit "Qytetar nderi" i Deçanit, gjenerali John Boyd është shprehur shumë falënderues, duke thënë se nuk do të harrojë asnjëherë këtë ditë pasi, sipas tij, i jep një vulë miqësie së përfundimit me Deçanin.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se vendimi për ta shpallur gjeneralin Boyd 'Qytetar nderi' është vendim i qëlluar dhe fisnik i Komunës së Deçanit. Duke folur për miqësinë ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së, Haradinaj ka thënë se populli duhet ta luajë pjesën e tij për ta ruajtur këtë miqësi. "Një mënyrë për ta shpërblyer përkrahjen e madhe që Amerika i ka dhënë Kosovës është që të qeverisim mirë, t'i krijojmë vendet e punës, por një tjetër mënyrë është që t'i respektojmë komunitetet e tjera etnike që jetojnë në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

Aforizma për politikanët që dëgjojnë (II)



Prof. Lisen BASHKURTI

- Çdo shoqëri krijon me kohë modelet e veta politike që i prijnë zhvillimit, por me kalimin e kohës edhe modelet më të arrira ç'vlerësohen. Prandaj, modeli politik që sot është i kohës, nesër del jashtë kohe. Kësaj dukurie nuk i shpëtojnë as liderët si personalizime të modeleve politike.

- Nëse, për arsye të ndryshme, një politikan nuk i ndihmon dot të tjerët me suksesin e vet, lypset të jetë i kënaqur që i lë trashëgimi gabimet e tij për të mos u përsëritur nga pasardhësit.

- Njerëzit duhet t'u ruhen politikanëve që premtojnë shumë sepse pa pikë dyshimi janë gënjeshtarë të mëdhenj.

- Një politikan që fillon të mendojë për veten e vet se është i pathyeshëm, duhet ta kuptojë se ka hyrë në fazën e rënies së tij të pashmangshme.

- Në politikë, dëliri i madhësisë

të shpie në butafori që prodhohet nga mbivlerësimi i vetvetes dhe nënvlerësimi i të tjerëve.

- Madhështia e një politikanit qëndron jo në atë që mendon ai për veten, por në atë që të tjerët mendojnë për të.

- Njeriu e politikës shpeshherë nuk e thejnë armiqët e shumtë, të cilët në jo pak raste e forcojnë. Njeriu e politikës shpeshherë e thejnë miqtë e paktë, të cilët në shumicën e rasteve e dobësojnë.

- Në politikë humbja e miqve vjen në çdo rast prej gabimeve të politikanit, ndërsa rritja e armiqve në ndonjë rast mund të vijë edhe për shkak të sukseseve të tij.

- Një politikan vdes politikisht jo sepse e thërret vdekja, por sepse e godet jeta.

- Arroganca politike në demokracinë liberale është në thelb shprehje e politikanit kompleksiv, që me anë të saj përpiqet t'i mbulojë paaftësitë, dobësitë dhe dështimet e tij.

- Arroganca e politikanit rrënon marrëdhëniet njerëzore, që përbëjnë themelet afatgjata të suksesit dhe të trashëgimisë së tij. Pra, sjellja arrogante është vetëvrasje politike.

- Një politikan i fuqishëm nuk e demonstroi forcën ndaj popullit,

opinionit publik dhe medias. Ndaj atyre demonstroi vetëm qetësi, qetësia e mban fuqinë politike nga brenda dhe reflekton butësi nga jashtë.

- Politikani arrogant i trembet transparencës, prandaj i kundërvihet opinionit publik dhe medias, duke tërhequr kështu përbuzjen e tyre dhe duke thurur vetizolim.

- Politikani arrogant përfundon në paranojak, sepse jashtë vetes së tij të gjithë i duken armiq, e kur nuk ka të tillë, i shpik vetë.

- Politikani arrogant mbështetet vetëm te servilët dhe mediokrit që janë patericat më të paqëndrueshme të pushtetit të tyre.

- Politikani arrogant, kur e sheh se nuk hyn dot në histori me vepra humane të mëdha, tenton të hyjë në gjeografi me vepra materiale të vogla.

- Politikani arrogant prodhon dukuri dramatike për të tjerët, por përfundon në mënyrë komike për veten.

- Politikani arrogant tenton të fusë nën kontroll gjithçka, por me këtë veprim humbet kontrollin mbi çdo gjë.

- Politikani arrogant sundon me goditjen e pushtetit nga lart-poshtë, por në fund të fundit bie prej goditjes së pushtetit nga

poshtë-lart.

- Politikani arrogant është butaforik sepse duket madhështor, por është i vogël; duket i fuqishëm, por është i dobët; duket trim, por është frikacak; duket intelektual, por është mediokër; duket afatgjatë, por është jetëshkurtër; duket tragjik, por është komik.

- Një lider politik quhet i mbaruar kur e humbet moralitetin. Moraliteti nuk është i matshëm përherë me numra, por më së shumti me vlera. Vlerat janë më të pakta se numrat, por ato peshojnë më shumë. Numrat shkojnë e vijnë, vlerat mbesin. Numrat blihen e shiten, vlerat kurrsesi.

- Një lider egoist që nuk bëhet dot atraktiv me idetë e tij thelbësore, tenton të bëhet i tillë me performancën e jashtme sipërfaqësore.

- Një politikan pa filozofi politike nuk zotëron dot batutat politike, por luan me politikë batutash. Batutat politike shprehin mprehtësi dhe humor. Politikati e batutave shprehin mediokritet dhe vulgaritet.

- Politikani pa statistikë është dogmatik, sepse politika pa statistikë është dogmë. Mungesa e statistikës shpreh lakuriqësinë

e mendimit politik dhe përpjekjen për manipulimin e tij.

- Politikani që vrapon mbas politikave ditore dëshmon se nuk ka qëllim madhor në destinacionin e tij afatgjatë.

- Në punët dhe jetën publike të politikanit paraqitja e jashtme nuk bëhet nisur nga shijet dhe kënaqësitë personale, por nga etika dhe estetika në marrëdhëniet publike.

- Kujdesi dhe frika e bëjnë politikanin që të jetë vigjilent. Por, ndërsa kujdesi tregon karakterin e fortë dhe zgjuarsinë e politikanit, frika tregon karakterin e dobët dhe mediokritetin e tij.

- Politikani i mençur di të dallojë respektin dhe mirësjelljen nga nënshtrimi dhe servilizmi. Politikani që i ngatërron këto dy anë të kundërta të karakterit njerëzor nuk i dallon dot miqtë nga armiqët.

- Politikani i mirë ngandonjëherë e fsheh të vërtetën, por vetëm me qëllim që ta ruajë atë nga gënjeshtret.

- Për politikanin e mirë të vërtetat e hidhura janë më të vlefshme sesa gënjeshtret e sheqerosura. Të vërtetat mund ta hidhërojnë politikanin për momentin, por gënjeshtret e hidhërojnë atë për gjithë jetën.

Bashkëpunimi në mes të auditorëve ka shënuar përparim të rëndësishëm

Në Shkup ka filluar punimet konferenca rajonale për bashkëpunim midis institucioneve supreme të auditimit dhe parlamenteve të cilat i ka hapur Naser Ademi, Auditor i Përgjithshëm i Maqedonisë në detyrë, ndërsa përvojat e tyre i kanë prezantuar edhe përfaqësues nga Gjermania, Turqia, Bullgaria, Polonia, Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi dhe Kosova

SHKUP, 31 MARS (ER)- "Bashkëpunimi në mes të auditorëve dhe deputetëve ka shënuar përparim të rëndësishëm për ta rritur ndikimin e auditimit të jashtëm", kështu ka thënë në Shkup, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, në konferencën rajonale "Bashkëpunimi në mes të Zyrës Shtetërore të Auditimit dhe Parlamentit", ku po marrin pjesë edhe përfaqësues të lartë nga vendet e rajonit dhe më gjerë. Auditori i Përgjithshëm i Kosovës



në këtë konferencë ka prezantuar në panelin e parë përvojën dhe praktikën e bashkëpunimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit me Parlamentin në Kosovë. Mes të tjerash, gjatë prezantimit Osmani ka nënvizuar rezultatet dhe shembujt konkretë të Kuvendit dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit përmes të cilave janë përmirësuar

shërbimet dhe është arritur vlera për para si dhe aktivitetet që janë ndërmarrë për përmirësimin e dialogut midis auditorëve dhe deputetëve me qëllim që këta të fundit t'i përdorin raportet e rekomandimit për t'i mbajtur në llogaridhënie institucionet ekzekutive.

Punimet e konferencës kanë

vazhduar me prezantime dhe diskutim në panelin e dytë me temë "Përcjellja e rekomandimeve të auditimit nga parlamenti".

Deputetë dhe auditorë nga rajoni kanë shkëmbyer mendimet e tyre lidhur me përvojat e tyre dhe se si ndikimi përmes auditimit mund të rritet. Në margjinat e kësaj

konference Osmani ka pasur rastin të bisedojë me homologët dhe përfaqësuesit e shumë vendeve për ta rritur bashkëpunimin bilateral në fushën e auditimit të jashtëm. Kjo konferencë është organizuar në vigjilje të shënimit të 20-vjetorit të themelimit të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut.

Në Turqi janë mbajtur zgjedhjet lokale

Ankara, 31 mars - Në Turqi janë zhvilluar votimet në zgjedhjet lokale që shihen si një provë e fortë për presidentin Recep Tayyip Erdogan, ku partia e tij rrezikon t'i humbë postet e kryebashkiakëve të Stambollit dhe Ankarasë. Recesioni ekonomik dhe inflacioni i thellë janë motivet kryesore në zgjedhjet së dielës. Rezultati për Stambollin, qyteti më i madh i Turqisë, njëkohësisht

edhe qendra financiare e vendit, ende është vështirë të parashikohet. Megjithatë emri i presidentit Erdogan nuk është në fletëvotime, ai ishte i përfshirë direkt në fushatën për zgjedhjet lokale. Shumë analistë e komentuan angazhimin e tij si shenjë se ai është realisht i shqetësuar se partia e tij mund të humbasë në gara kryesore. Erdogani zhvilloi

dhjetëra tubime gjatë ditëve të fundit në Stamboll për të konsoliduar mbështetjen për partinë e tij. Në të gjitha fjalimet ai përpigjet të largojë vëmendjen nga ekonomia duke u përqendruar te siguria e vendit dhe duke ngritur shqetësime për kërcënime nga separatistët kurdë. Një temë tjetër ka qenë agjenda e tij fetare. Ai ka luajtur në disa



Liga Arabe pritet ta kundërshtojë vendimin e SHBA-së mbi Rrafshnaltën e Golanit

Në draftin e deklaratës përfundimtare të samimit njëditor të burrështetasve të Ligës Arabe pritet të bëhet thirrje që vendimi i presidentit amerikan, Donald Trump të bëhet "i pavlefshëm"

TUNIZI, 31 MARS - Burrështetasit arabë pritet të mblidhen të dielën në një samit, për të kundërshtuar vendimin e Shteteve të Bashkuara, për të njohur sovranitetin e Izraelit mbi Rrafshnaltën e Golanit. Forcat izraelite e kishin pushtuar këtë rajon nga Siria gjatë Luftës Gjashtëditëshe të vitit 1967.

Më 1981, Izraeli vendosi ligjet e veta në rajon, duke e aneksuar atë - një vendim ky që nuk është njohur nga komuniteti ndërkombëtar.

Disa aleatë të SHBA-së në rajon, përfshirë Arabinë Saudite, kanë kritikuar vendimin e Uashingtonit mbi

Rrafshnaltën e Golanit, duke paralajmëruar se kjo do të ketë ndikim në stabilitetin rajonal. Në samitin njëditor të Ligës Arabe, që mbahet të dielën në Tunizi, pritet të bëhet thirrje që vendimi i presidentit amerikan, Donald Trump të bëhet "i pavlefshëm", thuhet në draftin e deklaratës përfundimtare të këtij samiti.

"Golani është një tokë siriane e okupuar, sipas ligjit ndërkombëtar dhe rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara", tha gjatë kësaj jave, kreu i Ligës Arabe, Ahmed Abdul Gheit.

"Çdo vendim nga cilido shtet që bie në kundërshtim me këtë



fakt, nuk ka vlefshmëri ligjore", tha ai. Vendimi i Trumpit lidhur me Rrafshnaltën Golan, vjen pasi

vitin e kaluar, SHBA-ja zhvendosi ambasadën e saj nga Tel-Avivi në Jerusalem, gjë që shkaktoi zemërim në rajon.

Siria është suspenduar nga Liga Arabe që prej vitit 2011, pas shtypjes së protestave, që nxitën fillimin e luftës civile.

Berlusconi garon për deputet në Parlamentin Evropian

ROMË, 31 MARS - Ish-kryeministri i Italisë, Silvio Berlusconi tha se ai do të garojë në zgjedhjet e Parlamentit Evropian, që mbahen në muajin maj, pasi, siç u shpreh ai, dëshiron që të luftojë për një BE më të bashkuar.

Berlusconi, 82-vjeçar, e bëri publik lajmin për pjesëmarrjen e tij në zgjedhjet e Parlamentit Evropian, gjatë konventës së partisë së tij të qendrës së djathtë Forza Italia, e cila ka humbur mbështetjen viteve të fundit, për shkak se votuesit kanë zgjedhur parti të tjera të djathta, që kanë diskurs anti-migrantëve dhe janë



euroskeptikë, siç është Partia Liga. Kjo parti udhëheq me Italinë dhe është në koalicion me lëvizjen "Pesë Yjet".

Partitë e koalicionit qeverisës në Itali dëshirojnë që të ndalin procesin e integritimit evropian dhe që fuqia të rikthehet te qeveritë e shteteve të BE-së. Por, Berlusconi tha se dëshiron pikërisht të kundërtën. Ai tha se dëshiron që Evropa të "rikthehet në projektet e themeluesve të saj, të cilët dëshironin një Evropë më të bashkuar, një Evropë me një politikë të jashtme të përbashkët dhe me një politikë të përbashkët të

mbrojtjes".

Berlusconi tha se nëse Evropa bashkohet ushtarakisht, atëherë do të ishte "fuqi" e madhe botërore.

Berlusconi, që ka shërbyer për tri mandate si kryeministër i Italisë, në muajin janar fillimisht e kishte përmendur mundësinë e garimit në zgjedhjet evropiane.

Për gati pesë vjet, Berlusconi i ishte ndaluar që të garonte për ndonjë post publik, pasi ishte dënuar për mashtrim me taksa. Por, vitin e kaluar, një gjykatë vendosi që t'ia heqë këtë ndalesë.

Kritikja e qeverisë bëhet presidentja e parë e Sllovakisë

BRATISLAVË, 31 MARS - Avokatja liberale dhe kritike e Qeverisë, Zuzana Caputova ka mposhtur kundërkandidatin e saj me një diferencë të lartë, për t'u bërë presidentja e parë grua e Sllovakisë.

Me pothuajse të gjitha votat e numëruara, Caputova ka fituar 58,4 për qind të votave në raun-

din e balotazhit. Kundër-kandidati i saj, Maros Sečovič, një kandidat i pavarur, por që ka gëzuar mbështetjen e partisë në pushtet, Partia Social-Demokrate, ka fituar 41,6 për qind të votave.

Sečovič, nënkryetar i Komisionit Evropian dhe ish-anëtar i Partisë Komuniste, pranoi humbjen pak

para mesnatës më 30 mars. Ai gjithashtu konsiderohet si pro-evropian, por gjatë fushatës kishte thënë se Sllovakia duhet t'i mbajë për vete disa kompetenca vendimarrëse.

Caputova kishte fituar raundin e parë të votimeve, që u mbajtën dy javë më parë, duke arritur të marrë 40 për qind të votave.

Sečovič, në këtë raund kishte fituar mbi 18 për qind të votave. Korrupsioni dhe ndryshimi kanë qenë temat kryesore para raundit të balotazhit, i cili është mbajtur një vit pasi gazetari, Jan Kuciak - i cili kishte hetuar për rastet e mashtrimit të zyrtarëve të lartë - dhe e fejuara e tij, ishin vrarë në shtëpinë e tij.



Horizonti i së kaluarës dhe sfondi social në romanin 'Misiri i vogël'

Ferdi KAMBERI, sociolog

Sa herë që flasim për romanet në kontekstin sociologjik ata pranohen si formë e narracionit, e cila një pjesë është fikcion, pjesa tjetër realitet përmes të cilit autori përçon një mesazh. Konsiderohet si vepër e trillimit, e cila përmes personazheve të paraqitura shpërfaq problemet në kontekstin social, dramatisimin e tyre, botëkuptimin, preokupimet, si dhe një imagjinatë sociologjike e cila reflekton gjendjen dhe efektet psikologjike, sociale, ekonomike, politike dhe kulturore të një shoqërie.

Romani i autorit Hysen Beqa, me titull *"Misiri i vogël"*, qysh në fillim parapërgatit lexuesin shqiptar se ky roman përmban karakter të ngjarjeve reale dhe fiktive të cilat mundohen që një ose tjetrën mënyrë t'i japin një kritikë sublimë dhe konstruktive realitetit të cilën jetuam dhe jetojmë. Autori, madje, në fillim të këtij romani thekson se *"...ky roman nuk është autobiografik, por shumë prej ngjarjeve të disa kapitujve janë të lidhura me realitetin tim dhe tuajin, me vendim tim të punës dhe përditshmërinë tonë. Ngjarjet në roman, veçanërisht personazhi, Iliri, (i cili si emër në kontekstin socio-historik na ndërlidhet me paraardhësit e shqiptarëve, ilirët, kujtesën historike, mitologjike dhe sfondin kulturor të tyre etj.) është mishërim i jetës së gjithsecilit që jeton në këtë kohë"* (H. Beqa, f. 10). Romani përmban gjithsej 127 faqe dhe është botuar nga shtëpia botuese "Armagedoni" në Prishtinë në vitin 2019.

Horizonti i së kaluarës dhe sfondi social

Në këtë roman pothuajse gjatë gjithë kohës personazhi kryesor është Iliri për të cilin autori shpeshherë flet në vetën e parë dhe të dytë. Në këtë kontekst, romani shpërfaq fëmijërinë e Ilirit në një fshat të Gjakovës, të cilin babai i tij e quante "Misiri i vogël", që ka qenë edhe frymëzim i autorit për ta titulluar këtë roman po me këtë emër. Romani fokusohet në mënyrën e jetesës para vitit 1999, sistemin patriarkal të familjes, nuancat e realitetit të asaj kohe, raportet ndëreshoqërore ndërmjet

shqiptarëve, kohën e lirë dhe aktivitetet e të rinjve, në mesin e tyre edhe të Ilirit, pastaj torturat e pushtetit serb që çdo ditë rëndonin ndaj shqiptarëve duke i detyruar t'i dorëzonin armët dhe që shpeshherë rezultonin se informatorët ishin kryesisht njerëzit e njohur, si dhe paraqet kontekstin e jetës së asaj kohe e cila, edhe pse ishte e varfër dhe me plot probleme dhe sfida, kishte edhe disa nuanca, duke u dhënë kolorit disa vlerave të mirëfillta, solidaritetit në mes të njerëzve, altruizmit dhe ruajtjes me një fanatizëm të identitetit kombëtar dhe atij fetar.

Romani në pjesën e parë paraqet gjendjen e shqiptarëve të Kosovës që nga vitet '70 e këtej, planet e Titos dhe idenë e "Bashkim - Vllaznimit" dhe masat afirmative për të krijuar një identitet "jugosllav", pastaj udhëton në kohë dhe fokusohet në masat e dhunshme të pushtetit të Millosheviqit, nevojën për edukim dhe shkollim të shqiptarëve, e shkollimi bëhej kryesisht në shtëpitë private.

Çështje tjetër për të cilin flet romani është edhe patriotizmi dhe guximi i shqiptarëve përballë regjimit serb, si dhe lidhja e veçantë me ShBA-në e cila ishte e pranishme te shqiptarët qysh herët. Lidhur me këtë autori në roman flet për mënyrën se si shumë shqiptarë, në mesin e tyre edhe Meti (babai i personazhit kryesor,

Ilirit), mbanin simbole të ndryshme nga brendët amerikane, që ishte edhe një mënyrë për të shpërfaqur një lidhje të veçantë me ShBA-në siç ishte rasti i Metit, që kishte një armë të quajtur "Gold amerikan". Autori këtë situatë e paraqet në formën e një hermeneutike, duke përshkruar situatën e asaj kohe me plot ndodhi dhe tregon se Meti ishte ftuar nga ana e policisë serbe për ta dorëzuar armën. Që mos ta dorëzonte armën ishte detyruar të shkonte te miku i tij, Musai, që ta ndërronte këtë armë me një armë tjetër dhe ta dorëzonte. Duke spikatur këtë raport me simbolet amerikane, autori në mënyrë kontekstuale e përshkruan këtë situatë në këtë formë: "Meti i dha atij (Musait) në këmbim 'Goldin amerikan', ndërsa ish-pistolletën e vet e dorëzoi të nesërmen në stacionin policor më të afërt. I kishte mbetur merak ai 'Gold amerikan' dhe nuk e hiqte dot nga goja, pasi e përmentte shpesh dhe i dhimbsej sikur ta kishte pasur të shenjtë" (H. Beqa, fq. 28).

Një qasje tjetër për të cilën romani flet është edhe koha e shpërfaqjes së luftës në anën e Gjakovës me rrethinë, ku autori në roman paraqet gjendjen e rëndë në atë kohë, dilemat hametliane "të jesh apo të mos jesh", bombardimet e NATO-s, kolonat e njerëzve dhe rrugën

për në Shqipëri të personazheve të trajtuar në roman, flijimin e njerëzve për liri, si dhe shumë çështje të tjera të cilat përjetuan personazhet e apostrofuara në roman.


Kthimi, liria dhe realiteti ynë shoqëror

Një pjesë e rëndësishme e këtij romani flet edhe për kthimin dhe shpeshherë dialogun dhe interdialogon përmes personazhit, Ilirit, i cili mendonte se kishin fatin e njëjtë të hebrenjve të cilët për mijëra vjet ishin bërë nomadë. Andaj, autori në roman këtë situatë e përshkruan në këtë mënyrë: "Në shtetet përreth Kosovës ishin ngrehur kampe refugjatësh që dukeshin si kampe përqendrimi në kohën e holokaustit të stërmëshur me gra, burra dhe fëmijë që prisnin në radhë çdo mëngjes e shtyheshin deri në rrahje për të kapur një copë bukë që punëtori i një organizate të huaj i hidhte nga rimorkio i kamionit" (H. Beqa, fq. 41). Pikërisht në këtë pjesë autori fokusohet në realitetin e Ilirit dhe të tjerëve që kishin humbur shpresën se një ditë mund të ktheheshin në Kosovë, si dhe gëzimin e tyre me t'u njoftuar se armiku ishte ikur dhe forcat e NATO-s ishin të vendosura në Kosovë.

Romani trajton edhe çështjen e përjetimit të lirisë nga Iliri,

rrugëtimin e tij drejt shkollës së mesme, pastaj universitetit, jetën sociale, kulturore, fetare në Gjakovë, dialogun me përfaqësuesit e organizatave me profil fetar të cilat kishin ardhur në Kosovë, kinse në emër të humanizmit, rrugëtimin dhe ngritjen e tij drejt punësimit në administratën publike, martesën dhe krijimin e familjes së tij. Romani, gjithashtu, trajton edhe shumë ngjarje të cilat apriori ndërlidhen me personazhin kryesor të këtij romani, me Ilirin dhe jetën politike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore të tij dhe neve si shoqëri. Siç shihet, autori përmes këtij romani, siç e pohon edhe vetë, ka bërë një luftë të pamëshirshme kundër mentalitetit patriarkal të shoqërisë shqiptare, thyerjes së tabuve dhe se romani është edhe një thirrje në vete për ndryshimet të cilat duhet të bëhen në shoqëri dhe nevojën për një emancipim i cili apriori ndikon në zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

Prandaj, në pika të shkurtra jemi munduar që këtë roman ta analizojmë dhe recensojmë përmes skanerit sociologjik dhe shumë gjëra të cilat romani trajton i kemi lënë qëllimisht pa i vendosur në këtë skaner, në mënyrë që lexuesi shqiptar ta lexojë, ta trajtojë dhe të vlerësojë në sfondin e mendimit kritik.



E rrallë

Shitet 170 mijë euro ora e dorës së Muamar Gadafit

Një nga orët e dorës, që i përkisnin ish-udhëheqësit libian Muamar Gadafit, u shit në ankand mbi 170 mijë euro, shtatë herë më lart se vlera reale e saj. Vlera origjinale në fakt, e larë në ar të bardhë dhe 18 karat, ishte rreth 20 mijë euro. Në shiritin "Blue Tiffany" ka një mbishkrim në arabisht:



"Vetëm në kohë nevoje do ta gjeni lirinë", të shoqëruar nga nënshkrimi i Gadafit.

BARSOLETA E DITËS



Babai: Cila është arsyeja që ke kaq shumë mungesa në lëndën Gjuhë shqipe?

Djali: Nuk e di, nuk kam qenë aty.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

"THE KID WHO WOULD BE KING",

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

"CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

"U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min


Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

FOTO E DITES



Balta arrin lumin Paraopeba pas hapjes së një dige në një minierë hekuri që i përket kompanisë minerare 'Vale' në Brumadinho të Brazilit. Fotografia është bërë nga: Douglas Magno. /AFP/

E jashtëzakonshme

Gruaja bëhet operacion për ta hequr peshkun nga barku

Një grua në Brazil i është nënshtruar një operacioni për ta hequr peshkun mustak nga barku i saj. Ai iu ngulit derisa ishte duke notuar në vendpushimin e plazhit në Sao Paulo të Itanhaemit. Turistja u dërgua në spital, ku peshku u nxor nga lëkura e saj me anë të kirurgjisë, kanë raportuar mediet e huaja.




 <p>DASHI Perceptimi juaj se dikush ju ka mashtruar në një çështje pune do të rezultojë i vërtetë.</p>	 <p>DEMI Po ndiqni një informacion të dhënë nga një person që nuk e njihni dhe aq mirë. Do të rezultojë i saktë.</p>	 <p>BINJAKËT Gjërat janë ashtu siç keni pritur dhe kjo gjë ju ka sjell një lloj relaksi që po ju pëlqen.</p>	 <p>GAFORRJA Jeta sentimentale është në kulmin e saj dhe po prisni ta finalizoni me diçka akoma më të rëndësishme.</p>	 <p>LUANI Shoqëria e mirë dhe miqtë do të jenë ata që sot do të përkujdesen për t'ju bërë qejfin. Ndiheni mjaft të përkëdhelur.</p>	 <p>VIRGJERESHA Partneri ka vendosur t'ju jap një lajm surprize. Nuk do ta prisni aq mirë sa mendohej.</p> <p style="text-align: right;">PESHORJA</p>
 <p>NËNE Nëse keni marrë vendime që s'i keni konsultuar me parë me të tjerët duhet të merrni përsipër dhe përgjegjësitë nëse rezultojnë të gabuara.</p>	 <p>AKREPI Jeni mjaft të favorizuar nga yjet sot dhe çdo iniciativë e juaja do të vlerësohet. Merrni me seriozitet lidhjen sentimentale.</p>	 <p>SHIGJETARI Jeni karaktere impulsive dhe sot do ta vërtetoni këtë gjë. Një situatë stresante do të komplikohet me shumë nga ju.</p>	 <p>BRICJAPI Natyra juaj e qetë ka bërë që persona rreth jush të fillojnë të tregohen. Keni kujdes nga këta persona.</p>	 <p>UJORI Shpirti liberal dhe aventuresk do të triumfojë sot dhe ju do të jeni të rrethuar me persona që duan të provojnë të njëjtat eksperiencë.</p>	 <p>PESHQIT Keni kompensuar kohen e humbur dhe sot do të jeni pranë personave që ju duan. Po e shijoni çdo moment.</p>

Shtyhet turneu i 'The Rolling Stones', Mick Jagger ka nevojë për trajtim mjekësor



Rolling Stones ka shtyrë turneun në veri të Amerikës, i cili ishte planifikuar të fillojë më 20 prill. Përmes një deklaratë u bë me dije se vokalisti i grupit Mick Jagger është këshilluar nga mjekët se nuk mund të shkojë në turne në këtë kohë pasi ka nevojë për trajtim mjekësor. Mjekët kanë këshilluar

Mick të bëjë një rimëkëmbje të plotë në mënyrë që ai të mund të kthehet në skenë aq më shpejt që të jetë e mundur. "Jam i mërzhitur që është shtyrë turneu, por unë do të kthehem në skenë sa më shpejt që mundem. Edhe një herë, më falni të gjithë", është thënë në këtë deklaratë.



Kylie Jenneri shkëlqen në të bardhë

Ylli televiziv Kylie Jenner ka shpërndarë disa fotografi në rrjete sociale. Jenneri ka bërë me dije se është diku për pushime, por nuk ka treguar vendin. Ajo pati

të veshur një fustan të bardhë që i rrinte shumë bukur. Jenneri më tej i lajmëron adhuruesit e saj që buzëkuqin që bart ajo mund ta blejnë online në dyqanin e saj.

Edhe shtatzënë, edhe mbretërore, Meghan Markle gjithmonë stil



Derisa shumica e nënave shtatzënë zgjedhin të veshin rroba sa më të rehatshme me kalimin e muajve, dukësja e Sussex zgjedh ta ruajë stilin mbretëror të veshjes, por që po kap shifrën e

gjysmë milion paundësh. Thuhet se Meghan hoqi dorë nga pamja tradicionale e lindjes, sepse ajo është "e papërshtatshme". Në vend të kësaj, ajo zgjodhi krijimet e projektuara me porosi.

Robin Thicke takohet me ish-gruan



Robin Thicke duket se ka marrëdhënie të mira me ish-bashkëshorten Paula Patton. Ish-çifti është parë në një takim javën që lamë pas në Malibu në Kaliforni. Derisa Robini dukej serioz, Paula u pa

e buzëqeshur. Paula dhe Robini ishin të martuar për tetë vjet para se të ndaheshin në shkurt të vitit 2014. Ata kanë një fëmijë tetëvjeçar bashkë. Robin tani është i martuar me April Love Geary, me të cilën ka dy vajza.



		Autor: GAZMEND MORINA	BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE, ME KËRCELL TË GJATË (sh.shq.)	SHUMË I LODHUR, I KËPUTUR	EMËRORE, RASA E PARË E LAKIMIT (gram.)	LLOJ PAPAGALLI	FUTBOLLISTI ALTIN	SHTET I LASHTË NË EVROPË	NJË NGJYRË	I ÇMPREHE	ME VËSHTRËSI, ME SHUMË MUNDIM	EPOKA E RE	PJESË E MEKANIKËS QË STUDIOJ LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE
	MBARIM, PËRFUNDIM											BASHKËTING. TEFIK OSMANI	
	PAMORAL-SHMËRIA												
	SHTET NË AFRIKË (pashq.)								GAZ QË PËRDORËT PËR TË PASTRUAR PLAGËT ANA MERO				
	REGJISORI GJERMAN ... EDEL QYTET I YNI				ZEZAKU; I ZIU ISH BENDI MUZIKOR ANGLEZ "..... KITTEN"							ZANORE RRJET I QARKULLIMIT TË AUTOMJ-ETEVE	
	→						PËREMËR PRONOR				DY BASHKË-TINGËLLORE RRYMË AJRI QË LËVIZ NË DREJTIME TË NDRYSHME		
	PIKTORI YNË ... VALLA						ZANORE BËRJE MË I RI		AKTORJA AMERIKANE ... GARR ALTINI (perkdh.)				
	KUJDESTAR (lat.)							KA A DEM I PATREDHUR MARKË E TELEFONAVE CELULAR					
EPOKA E RE	KËNGËTARJA KANADEZE NË FOTO LAVIGNE	KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVROPIAN	ZBAVITËS, TËRHEQËS	NIKEL	KUFI	ZANORE	QYTET NË ITALI MALESOR				"F" në mes të dy "A" PRARJ		
	GRADIM, PËRPARIM	○							AKTORJA AMERIKANE ... RYDER (shqip.) MOTOÇIKLETA (bised.)			ZANORE MARRJE E TIPAREVE TË PARAARDHËSVE TANË	PËRGËZIM
	QYTET NË KOSOVË	○				ALYSA MILANO MOR, HEJ (pashq.)		BIMË QË BËN KOKRRA TË THARA (shq.) ENDACAKE					
	RENIUM, REOMIR	○			SKLLAV I LIRUAR (hist.) FUTBOLLISTI BRAZILIAN ... SILVA (MILAN)			NOTË MUZIKORE KALORËS MESJETAR			OHAJO, LUIZIANA AKTORI YNË ... HAZIRI		BASHKËTING. KËNGËTARJA SHQIPTARE ANILA
	ZEMËRIM, EGËRSIM	○			PJESË RROTULLUESE E NJË APARATI MITRUSH KUTELI				SHKOLLIMI, ARSIMIMI (bised.) ARKIVI I FILMAVE				
	LAKESË	○				AKTOR KOMEDISH MODELJA SHQIPTARO-AMERIKANE ÇUNMULAJ				ZANORE BASHKËTING.		SHTEG SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE (pashq.)	
EPOKA E RE	QESËNDISJE	KËNGËTARJA ANITA ... TMERR				ZYRTARIZIM I NJË MARR-ËVESHJE NDËRKOMBËTARE BURIMI							SMIRË
	I DOBËT, TINËZAR				BENDI MUZIKOR "IRON" PËRMBLEDHJE E SISTEMUAR UDHËZIMESH (shq.)								SHPEND I EGËR ME BISHT TË GJATË DETERGJENT PËR DUAR
	SHFUQIZIM I NJË AKTI JURIDIK						KËNGËTARI ITALIAN RAMAZZOTTI DREJTOJ NJË AUTOMJET					KËNGËTARJA JONË ... SHKODRA BASHKËTING.	
	OMANI, BENINI		FUTBOLLISTI BEHRAMI		BASKETBOLLISTI TURK OMER ... AKTORI FRANCEZ DELON (shq.)			MODELJA SHQIPTARE FEJZULLAHU	GOTË PREJ METALI BASHKËTING.			SHOK, JARAN GJELLË E PËRGATITUR VETËM ME ORIZ	
	SHTET FEDERAL NË SHBA					MYNXYRË: HALL I MADH AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBREN					PESCARA, IVREA AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... REID		ZANORE SHTRESË E SIPËRME E AJRIT
	SHTET NË EVROPË (pashq.)					"R" pas dy "A" AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS			ARKË SHUMË E VOGËL PREJ KARTONI			ERBIUM EUROPEAN TRAIN ENTHUSIAST	
	KAMBANË FARE E VOGËL				BOSHTI ARIAN MALIQI				JETËSHKRIM (sh.shq.) DY BASHKË-TINGËLLORE				TONY ANDERSON
	ZANORE		MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT ISLANDA				SHKRONJA XXVIII & XXVI			PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA URUGUAI			
	I ULËT E I TILLË SA MË S'BËHET						FILLIMI I AGIMIT						SKANDALI

ZGJIDHJA E FJALËKRËJT: FINALIZIMI, AMORALITETI, SOMALI, REVOKIM, EROS, TINA, OB, ONAN, TAS, MIK, NEVADA, GAZEP, PI, A, ITALI, AAR, KUTI, ER, ZILE, AKSI, AVANCI, VINOVA, I, VITIA, AM, KIKIRIKU, RER, KOLON, MI, OL, R, INAT, ROTOR, ARSIMI, LAKIM, KOMIK, A, RIM, TAKE, RATIFIKIM, I LIG, MAIDEN, FAZAN, REVOKIM, EROS, TINA, OB, ONAN, TAS, MIK, NEVADA, GAZEP, PI, A, ITALI, AAR, KUTI, ER, ZILE, AKSI, AVANCI, VINOVA, I, VITIA, AM, KIKIRIKU, RER, KOLON, MI, OL, R, INAT, ROTOR, ARSIMI, LAKIM.

Sportet më të mira për të luftuar celulitin

Jo të gjitha aktivitetet fizike janë po aq të efektshme për të luftuar celulitin: le të shohim se cilat janë ato më të mirat

Pranvera është sezoni i vitit kur lufta kundër mbështetësve të urryer të celulitit nuk bëhet çerekfilli, duke pasur parasysh "testin e kostos" fatale: tani e dimë mirë, për të luajtur në formë të mirë në takimin me bikini është e nevojshme të luhet paraprakisht dhe nuk ka më kohë për të humbur. Celuliti është një çrregullim i përhapur, i cili nuk i kursen gratë shumë të reja apo edhe të holla, por edhe ata që janë të predispozuar mund të bëjnë shumë për të rregulluar problemin. Zgjidhja e tij plotësisht është shumë e vështirë, por së paku situata mund të përmirësohet. Natyrisht, para se të filloni një program trajnimi, është e këshillueshme që të kërkonit këshilla mjekësore dhe të sigurohuni që jeni në shëndet të mirë.

Të njohim armikun – Emri mjekë-

Sporti – Aktiviteti fizik është një nga mënyrat më të mira për të luftuar celulitin. Ai ka dy efekte të rëndësishme: djegia e kalorive ose yndyra (në varësi të llojit të trajnimit), do të ndikojë në stoqet e yndyrës që janë mbledhur në trup dhe në të njëjtën kohë tonifikon muskujt, duke rritur sasinë e masës së dobët dhe duke përmirësuar metabolizmin dhe mikrocirkulimin lokal. Në këtë drejtim, çdo aktivitet fizik është i dobishëm, edhe nëse ka sporte dhe disiplina që mund të jenë më efektive për një efekt të synuar kundër celulitit.

Aktivitetet aerobike – Ata janë gjithmonë më të mirë, cilido qoftë qëllimi që ne vendosim, përfshirë luftën kundër celulitit. Dy stërvitje aerobike në javë duhet të përfshihen gjithmonë në kalendarin tonë të fitnessit, edhe pse ne parapëlqej-



sor i celulitit është panikulopati edemato-fibro-sklerotik: kjo shprehje e vështirë tregon thjesht një gjendje të ndryshuar të hipodermës, një ind nënlëkuror që gjendet nën lëkurë dhe përbëhet kryesisht nga qelizat e yndyrës. Metabolizmi i saj lidhet me balancin kalorik dhe përbën, në thelb, rezervën e energjisë të organizmit. Sasia e yndyrës që gjendet në hipodermë varet nga shumë faktorë: kushtetuta e subjektit, ekuilibri i saj hormonal dhe zakonet e të ngrënit. Depozitimi i dhjamit ka tendencë të kthehet në celulit, kur ka ndryshime në mikrokriptimin e indit dhjamor, të cilat ndryshojnë metabolizmin.

jmë t'i kushtojmë vetes aktiviteve të ndryshme. Ecja me shpejtësi



duket të jetë veçanërisht efektive, madje më shumë se vrapimi: ecja e shpejtë (rreth gjashtë kilometra në orë) stimulon metabolizmin dhe prodhimin e endorfineve, të cilat na japin energji dhe humor të mirë, tonet e këmbëve, përmirëson sistemin kardio-vaskular dhe respirator, dhe gjithashtu djeg 350-400 kalori në orë. Vrapimi, në fakt, nuk mund të jetë sporti ideal: ata që janë mbipeshë, në fakt, janë të ekspozuar ndaj rreziqeve më të mëdha ndaj sëmundjeve dhe madje edhe goditjet e vazhdueshme ndaj të cilave trupi i nënshtrohet mund të përkeqësojë edhe situatën e atyre që vuajnë nga celuliti. Ecja, nga ana tjetër, edhe me ndihmën e shkopinjve (ecje nordike), është një aktivitet me më pak ndikim në trup dhe në nyje dhe prandaj është i përshtatshëm për të gjithë. U thoni gjithashtu stërvitjeve që synojnë këmbët dhe mollaqet, si p.sh. hapat, mbledhjet, goditjet dhe këmbët, që duhet të bëhen në shtëpi në palestër me ndihmën e makinave dhe veglave të vogla.

Biçikleta – Është një tjetër mik i madh i atyre që kanë disa "tampon"

për të djegur. Përveç që kërkon një shpenzim të rëndësishëm të energjisë, çiklizmi ka efekte shumë të dobishme në qarkullimin e gjymtyrëve të poshtme, një fakt veçanërisht i rëndësishëm pasi celuliti tenton të rrijë në kofshë dhe mollaqe. Nëse pedalimi në rrugë mund të jetë i komplikuar, sidomos për ata që jetojnë në qytet, mos harroni se gjysmë orë stërvitje me biçikletë janë po aq të vlefshme, edhe nëse ata janë më pak argëtuese. I thoni gjithashtu po hidrobike, ose një biçiklete të veçantë në të cilën ju mund të pedalonit ndërsa jeni me këmbë në ujë.

Uji – Është miku i madh i atyre që luftojnë celulitin: shpenzimet normale të energjisë të lidhura me aktivitetin fizik lidhen me rezistencën më të madhe të ofruar nga uji në të cilin është zhytur dhe përfitimi i masazhit të veçantë të drenazhimit që rrjedh nga fakti i lëvizjes në një element fluid. Noti, sporti më i thjeshtë në ujë, është jashtëzakonisht efektiv dhe është veçanërisht i dobishëm për ata që janë shumë mbipeshë: duke notuar me një ritëm të mirë mund të

djegësh edhe 500 kalori në orë. Një pikënisje e mirë mund të jetë një objektiv prej 500 metrash për trajnim për t'u rritur në mënyrë progresive për t'i dyfishuar ato. Nga ana tjetër, nëse noti nuk na kënaq, ekzistojnë lloje të ndryshme të aquagym ose hidrobike të lartpërmendur.

Jo vetëm sport – Vetëm trajnimi nuk është i mjaftueshëm: për të luftuar celulitin, është e nevojshme për të ngrënë ushqim të shëndetshëm, duke shmangur ushqimet yndyrore, kripën dhe përgatitjet e përpunuara: u thoni po pesë porcioneve në ditë, fruta dhe perime, mish të bardhë dhe peshk, gatim me pak yndyrë dhe shumë ujë të pijshëm; ndërkohë, u thoni jo ushqimeve junk, snacks, ëmbëlsirave, pijeve alkoolike dhe me gaz, kripës së shtuar. Është mirë që të shmangen rrobat shumë të shtrënguara që mund të pengojnë mikroçirregullimin lokal. Gjithashtu mund të jetë e dobishme për të trajtuar veten me një masazh të mirë, për ta bërë edhe vetë me një produkt të mirë anti-celulit për t'u përdorur çdo ditë. /Gazeta Shqip



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Flamurtari i bëri nder Prishtinës, ndali Feronikelin në 'Fadil Vokrri'

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 MARS - KF Flamurtari i ka bërë një nder të madh skuadrës tjetër nga kryeqyteti, Prishtinës, pasi e ka ndalur Feronikelin në barazim (0-0). Tash dallimi i pikëve në mes të "Niklit" në vendin e parë dhe Prishtinës në vendin e dytë është vetëm tri pikë. Prishtina të dielën me dy golat e shënuara nga Meriton Korenica e mposhti skuadrën e Ballkanit, kurse të shtunën fitores i është gëzuar edhe Drenica në përballje me KEK-un, kurse përballja në mes të Gjilanit dhe Flamurtarit përfundoi 1-1.

Flamurtari - Feronikeli 0-0

Flamurtari e ndali Feronikelin, duke luajtur baras (0-0) në ndeshjen kryesore të javës së 24-t në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Në pjesën e parë skuadër më e rezikshme u tregua Flamurtari, por rastet e krijuara nuk i shfrytëzuan Florim Bërbatovci dhe Alban Shillova. Në pjesën e dytë "Nikli" ishte më kërkues, por Kastriot Rexha, Mevlan Zeka Silva dhe Mendurim Hoti nuk arritën ta mposhtin portierin Flamur Neziri dhe ndeshja përfundoi 0-0. Pas kësaj ndeshje, Feronikeli mbetet lider në tabelë me 56 pikë, tri më shumë se Prishtina, duke e rihapur garën për titull. Flamurtari



është i nënti me 29 pikë të grumbulluara.

Ballkani - Prishtina 0-2

Meriton Korenica ka qenë vendimtar në fitoren e Prishtinës ndaj Ballkanit, pasi realizoi të dyja golat e fitores. Ndeshja e zhvilluar në Suharekë ka qenë mjaft e fortë, kurse Prishtina dominoi edhe në pjesën e parë, por pa mundur ta shënojë golin e epërsisë dhe dyzetepesë minutat e parë u mbyllën 0-0. Rezultati u zhblllokua në minutën e 71-të, kur Korenica shënoi një eurogol nga gjuajtja e lirë, derisa i njëjti futbollist e vulosi fitoren në minutën e 87, pas një

asistimi të mirë nga mesfushori Ergyn Ahmetit. Prishtina rikthehet në pozitën e dytë me 53 pikë, kurse Ballkani zë vendin e tetë me 29 pikë.

Gjilani - Trepça '89 1-1

Gjilani e nisi mirë ndeshjen ndaj Trepçës '89, duke shënuar gol në minutën e dytë, por në fund ndeshja përfundoi me rezultat të barabartë 1-1. Në minutën e dytë të ndeshjes Endrien Magani harkoi bukur deri te Wilber Perez, i cili shënoi me kokë për 1-0. Me epërsinë e një goli vendësit shkuan në pushim, por me të filluar pjesa e dytë, mitrovicasit arritën



IPKO SUPERLIGA

Flamurtari - Feronikeli	0-0
Ballkani - Prishtina	0-2
Gjilani - Trepça '89	1-1
KEK-u - Drenica	1-5
Liria - Llapi	1-2
Ferizaj - Drita	0-4

TABELA

	TABELA	PIKË
1. Feronikeli	24	56
2. Prishtina	24	53
3. Llapi	24	51
4. Drita	24	41
5. Drenica	24	33
6. Gjilani	24	33
7. Trepça '89	24	29
8. Ballkani	24	29
9. Flamurtari	24	29
10. Ferizaj	24	25
11. Liria	24	24
12. KEK-u	24	1

LIGA E PARË

Vllaznia - Drenasi	1-0
Trepça - Vushtrria	0-2
Besa - Bashkimi (K)	1-0
Vitja - 2 Korriku	2-1
Istogu - Fushë Kosova	2-1
Kika - Dukagjini	1-1
Vëllaznimi - Onix	4-1
Arbëria - Ramiz Sadiku	0-2

TABELA

	TABELA	PIKË
1. Vushtrria	21	50
2. Besa	21	47
3. Dukagjini	21	41
4. Vitja	21	40
5. Vëllaznimi	21	39
6. Onix	21	31
7. Trepça	21	27
8. Istogu	21	26
9. Arbëria	21	26
10. Fushë Kosova	21	23
11. Drenasi	21	22
12. Ramiz Sadiku	21	21
13. 2 Korriku	21	21
14. Vllaznia	21	21
15. Kika	21	20
16. Bashkimi (K)	21	16

t'i barazojnë shifrat me golin e shënuar nga Hasan Hyseni, i cili përfitoi nga rrëmuja e krijuar para portës së vendësve dhe pa vështirësi e dërgoi topin në rrjetë, duke vulosur njëherësh rezultatit përfundimtar të kësaj ndeshjeje (1-1). Të dyja këto skuadra do të luftojnë deri në fund të kampionatit për mbijetesë.

KEK-u - Drenica 1-5

Drenica e ka shkatërruar të

shtunën KEK-un, pasi në Obiliq e mundi me rezultat 5-1. Golat për skuadrën kuqezi nga Skenderaj i shënuan Qemail Elshani, Kreshnik Uka, Osman Mëziu, Atdhe Grajqevci e Nicholas Andres, kurse golin e vetëm për vendësit e realizoi Isa Emin Haziri. Skuadra e KEK-ut tashmë e ka siguruar vendin nga Superliga dhe ka vetëm një pikë të grumbulluar, kurse Drenica e përforcon pozitën e pestë me 33 pikë të grumbulluara.



Loriana Kuka ia sjell medaljen e dytë të artë Kosovës

Prishtinë, 31 mars - Dy medalje të arta në Grand Prixin, i cili u mbajt në Tbilisi të Gjeorgjisë, është bilanci i dy garuesve nga Kosova. Të dielën Loriana Kuka u ngjiti në podium, duke fituar të artën në kategorinë deri në 78 kilogramë. Garuesja Kuka në finale mposhti Kliema Antomarchi të Kubës, falë dy 'waz-ari'. Antomarchi dy vjet

më parë ishte medaliste e bronzit në Botërorin e Budapestit. Në përgjithësi, Loriana fitoi katër luftëra. Medalja e artë i sjell asaj 700 pikë të reja për Lojërat Olimpikë Tokio 2020. Dy ditë më parë, Nora Gjakova fitoi medaljen e artë në kategorinë deri në 57 kilogramë. "Dy herë fluturoi kubanezja. Lori

po na bën krenar pakufi, e artë në Grand Prix Tbilisi. Loriana Kuka po vazhdon edhe si pjesë e familjes ëndrrën time që më mbeti në gjysmë. Fundajavë e bukur për popullin e shtypur me shekuj. Liria e merituar për të rinjtë që i kemi", ka thënë trajneri Driton Kuka pas triumfit të Lorianës në Gjeorgji.


Rashica: Duam të fitojmë çdo ndeshje

BREMEN, 31 MARS - Ylli i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Milot Rashica, ka vazhduar formën fantastike në Gjermani dhe shpreson të vazhdojnë të fitojnë për ta arritur objektivin, që është pjesëmarrja në Evropa Ligë

në sezonin 2019/20. Rashica e ndihmoi me një gol dhe një asistim Werder Bremenin për të arritur fitore 3-1 ndaj Mainzit. "Ishte e rëndësishme ta shënonim golin e parë herët. Pas kësaj, ne kishim gjithçka nën kontroll.

Mendoj se në fillim të pjesës së dytë nuk ishim agresivë aq sa duhet, por u kthyem dhe bëmë diferencën me golin e tretë. Duam të fitojmë çdo ndeshje, më pas do të shohim se ku do të renditemi. Çdo pikë vlen diçka sepse po

bëhet luftë e madhe", ka deklaruar Rashica, duke shtuar: "Nuk do të jetë ndeshje e lehtë sepse do të luajmë në Schalke dhe kupa është gjithmonë ndryshe me Ligën. Por, pa marrë parasysh çfarë, ne duam të shkojmë para".



Zidane: Më pëlqen Pogba, Varane nuk largohet nga Reali

MADRID, 31 MARS - Zinedine Zidane e pranon hapur pëlqimin që ka për mesfushorin e Manchester Unitedit, Paul Pogbanë. Trajneri i Realit thotë se francezi bën gjëra befasuese në fushë prej aftësive teknike që ka. "Më pëlqen shumë Pogba

dhe kjo nuk është diçka e re. Unë e njoh personalisht, është ndryshe dhe bën gjëra që shumë të tjerë nuk i bëjnë. Ka shumë kualitet, di të mbrojë dhe të sulmojë. Ai nuk është lojtari im, por është i Unitedit dhe duhet ta respektojmë këtë gjë. Pogba ka

thënë se pas Mançesterit dëshiron të luajë te Reali. Por atij i pëlqen Reali më shumë sesa Zidane. Nëse përfundon përvoja e tij në Angli, përse të mos vijë në Madrid?", ka deklaruar Zidane, i cili foli edhe për mbrojtësin Varane. "E gjithë bota flet

shumë dhe njerëzit mund të japin mendime të ndryshme. Unë mendoj se Varane është një lojtar spektakolar dhe prej tetë vjetësh po bën gjëra fenomenale. E shoh të lumtur, të kënaqur dhe të përfshirë në skuadër", ka thënë Zidane.



Gjenerata që mund ta dërgojë Kosovën në botëror

PRISHTINË, 31 MARS - Është bërë publike edhe lista e lojtarëve të Përfaqësueses U21 të Kosovës në hendboll që do të paraqitet në IHF Trophy Intercontinental, që prej 10 deri më 14 prill mbahet në Prishtinë. Fituesi i fazës interkontinentale të garës prestigjioze IHF Trophy kualifikohet për në Botërorin e Juniorëve që në verë mbahet në Spanjë. Pra, ky është një rast historik për grupmohën e juniorëve të Kosovës, që për herë të parë në të gjitha sportet ekipore mund ta sigurojë paraqitjen në kampionat botëror. Gjenerata aktuale e ka fituar garën IHF Trophy për Evropë, për grupmohën U20, vjeshtën e kaluar në Prishtinë. Tani djelmohat tanë, të përkrahur nga tifozët, kanë rastin që me fitore në fazën interkontinentale të shkruajnë emrat e tyre në librat e historisë së sportit kosovar në përgjithësi. Përzgjedhësi i Kosovës, Taip Ramadani, së bashku me kryetrajinerin e U-21, Fatmir Muhaxheri dhe trajnerin Benon Brahushi, kanë publikuar emrat e lojtarëve me



Lista e hendbollistëve

Flakrim Beqiraj (GK KH Prishtina), Arti Luzha (GK KH Vëllaznimi), Lulzim Shabani (LW KH Kastrioti), Rinor Avdulli (LW HC Bülach), Aldi Rudari (LW KH Kastrioti), Festim Mustafa (LB KH Kastrioti), Jon Muqolli (LB KH Besa Famgas), Atdhe Basholli (LB KH Prishtina), Arben Dugolli (CB KH Kastrioti), Besian Abazi (CB KH Prishtina), Drenit Tahirukaj (RB KH Besa Famgas), Agon Bajqinovci (RW KH Prishtina), Labinot Gubetini (RW KH Vushtrria), Albin Xhafolli (RW VfL Gummersbach), Etrit Hoxha (PV KH Prishtina), Adrian Halili (PV HSG Ostsee N/G), Blend Dalladaku (PV HBC Nantes).

të cilët synohet sukcesi i madh. Edhe përfaqësuesja e juniorëve mbledhet sot (e hënë) dhe do të vendoset në hotelin AFA në Prishtinë. Janë ftuar lojtarët që kanë bartur barrën në vjeshtë e, po ashtu, në listë janë shtuar disa emra të rinj që bëjnë karri-

erë në shtete evropiane. Te juniorët në IHF Trophy Intercontinental do të garojnë Kosova, Nigeria, Taipei Kinez, Australia, Paraguai dhe ShBA-ja. Pra, janë kombëtares që kanë fituar garën IHF Trophy në nivel kontinentesh.

Hardeni, një përbindësh për Houstonin, fitojnë Toronto dhe Clippersat

HOUSTON, 31 MARS - Skuadra e Clippersit fitoi 132-108 ndaj Clevelandit, një ndeshje e dominuar nga kalifornianët, me Harrelli që realizoi 23 pikë, mbështetur edhe nga Shai me 22 pikë. Clippersi, aktualisht në vendin e gjashtë, synon të ngjitet edhe më tej në shkallët e renditjes në Perëndim. Surprizë fitorja e Brooklynit, që mundi 110-96 Bostonin, ndeshje me dy pamje. Pjesa e parë më e mirë për Bostonin, ku u dallua Hayward me 19 pikë, ndërsa në të dytin



erdhi përmbysja e vendësve, me Russellin që realizoi 29 pikë e 10 asistime. Toronto konsolidon vendin e dytë në Lindje, pas fitores 124-101 ndaj Chicagos, takim i dominuar nga miqtë, me 7 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë (Ibaka e VanVleet me nga 23 pikë secili). Fiton edhe skuadra e Houstonit,

që mundi 119-108 Sacramenton, sfidë e vendosur në periodën e katërt në favor të ekipit teksan. Hardeni, si gjithnjë magjik, autor i 50 pikëve, 11 reboundeve e 10 asistimeve, më i miri në fushë. Jashtë fushës fiton Philadelphia, që mundi 118-109 Minnesota, falë 25 pikëve të Harrisit.

SHKURT

Tottenhami kërkon 150 milionë euro për Eriksenin

Christian Eriksen është një nga lojtarët më të kërkuar. Danezi i Tottenhamit është ndër mesfushorët më të mirë në botë dhe Reali i Madridit po insiston shumë për t'i siguruar shërbimet e tij. Tottenhami ka rezistuar gjatë, por në fund është dorëzuar. Mosrinovimi i kontratës, që skadon në verë e vitit 2020, ka lodhur drejtuesit e "Spurs"-it. Këta të fundit kanë vendosur çmimin e lojtarit. Siç raporton "Mirror", klubi londinez e vlerëson vikingun 150 milionë euro. Kjo shumë është 10-fish më e lartë nga ajo që pagoi Tottenhami për kartonin e 27-vjeçarit tek Ajaxi në vitin 2013.

Ibra: Ronaldo, futbollisti më i kompletuar

Zlatan Ibrahimović nuk e ka fshehur kurrë admirimin për të. Suedezi i famshëm nisi futbollin në lagjet e varfra të Rosengorrit me një ëndërr në kokë: të bëhej një futbollist si Ronaldo fenomeni. Sot mund të ndihet krenar për karrierën e mrekulueshme që ka zhvilluar dhe futbollistin e madh që është bërë. Ibra ka folur për "MLS", duke u ndalur te idhulli i tij. "Ronaldo braziliani ka qenë futbollisti më i kompletuar, për mendimin tim. Sa herë që prekte topin ndodhte diçka. Ai ishte futbollisti. Ronaldo ishte një shembull i madh dhe futbollisti që çdokush ëndërronte të bëhej", ka thënë Ibrahimović.

Solskjaeri kërkon rikthimin e Zahas në 'Old Trafford'

Ole Gunnar Solskjaer po synon ta rikthejë në "Old Trafford", Wilfried Zaha. Trajneri i Manchester Unitedit e njeh mirë sulmuesin e Crystal Palaces, pasi ka punuar me të në vitin 2014, kur norvegjezi drejtonte Cardiff Cityn. Kujtojmë që Zaha u bë pjesë e "Djajve të Kuq" në vitin 2013, gjatë kohës që skuadra drejtohej nga Sir Alex Ferguson, por me uljen në stol të David Moyes ai nuk arriti të shfaqej në lartësinë e duhur, duke u huazuar fillimisht te Cardiffi e më vonë te Crystal Palace, që vendosi më pas ta blinte kartonin e tij. 26-vjeçari luan që nga vera e 2014-s me skuadrën e "shqiponjave", ndërkohë që ka një kontratë që përfundon në qershor të vitit 2023, por "djajtë e kuq" kanë para mjaftueshëm për ta prishur këtë bashkëpunim.

Gattuso: Ndaj Sampdorias ishim të pafat

Gennaro Gattuso e ka cilësuar të pafat ekipin e tij pas humbjes 1-0 në udhëtim te Sampdoria. Kjo ishte hera e parë që nga dhjetori 2017 që "rossonerët" kanë humbur dy ndeshje në Serinë A por, sipas Gattusos, ekipi i tij pati një paraqitje të mirë, edhe pse ishte i pafat. "Ne ishim shumë të pafat te goli, pastaj bëmë shumë gabime të thjeshta dhe e kishim të pamundur të luanim ashtu siç dëshironim. Megjithatë, kjo ishte një performancë e mirë. Kur Sampdoria po na shtypte, ne thjesht largonim topin, duke u dhënë atyre kohë për të marrë formë", ka thënë fillimisht Gattuso për "DAZN". "Ne erdhëm nga një humbje tjetër tek Interi. Kemi humbur sot në një incident të pafat, por ekipi u përpoq me çdo gjë për t'u rikthyer. Ka ende shumë ndeshje për t'u zhvilluar dhe ne nuk duhet të bëhemi të dobët", ka shtuar trajneri i Milanit.

Fulhami i shtohet garës për Conten

Tetë muaj pasi u largua nga drejtimi i Chelsea, Antonio Conte rikthehet sërish në Londër. Trajneri italian ka përfutur nga kjo mundësi për të parë pak futboll anglez. I ulur në tribunën e stadiumit, ish-trajneri i bluve të Londrës pa nga afër dominimin e Manchester Cityt që mori kryesimin e tabelës. Gjatë kësaj kohe ofertat për të kanë qenë të shumta dhe nga skuadra të mëdha, por nuk është çudi që ai ta marrë drejtimin e Fulhamit në fundin e këtij sezoni. Tifozët londinezë mund të ëndërrorjnë. Interi dhe Roma janë dy skuadrat që përflitet se e duan italianin si trajner të ardhshëm për të nisur një projekt fitues. Në Itali janë të sigurt se zikaltrit kanë arritur pajtimin për vitin e ardhshëm.

REZULTATET

Clippers - Cleveland	132-108
Brooklyn - Boston	110-96
Houston - Sacramento	119-108
Detroit - Portland	99-90
Indiana - Orlando	116-121
New York - Miami	92-100
Chicago - Toronto	101-124
Minnesota - Philadelphia	109-118
Phoenix - Memphis	115-120



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerziteti dhe Bolniçke i Klinike Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova University
 Clinical Center of Kosovo



Sektori i Personelit

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit të 4 Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik; Nenit 6 pika 1.1 dhe nenit 13 pika 1 dhe 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës, (SHSKUK), nenit 12, neni 13 pika 1 dhe neni 15 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; Nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; Nenit 5 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003 datë 21.07.2016 dhe Kërkesa elektronike e datës 27.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së shpallë:

KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

Nr	Kërkohen:	Klinika/Institutet/Sh.	Janë kërkuar:
1.	Mjekë Specialistë të Oftalmologjisë	Klinika Oftalmologjisë	1
2.	Mjek Specialist të Neurologjisë	Klinika e Neurologjisë	1
3.	Mjek Specialist të Urologjisë	Klinika e Urologjisë	1
4.	Mjek Specialist Internist për nevoja të Mjekimit Intensiv Qendror	Klinika Anestezionit dhe Mjekimit Intensiv	1

I. Koficienti i pagës: (8.4) Për Mjekë Specialistë
Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Shefit të Repartit të Klinikës në QKUK
Nr. i Referencës: QKUK – 13/2019-04/4

Qëllimi kryesor i vendit të punës për Specialistë:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka.

Përgjegjësit kryesore të mjekut specialist:

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, pajisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletlëshimi, protokollit etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditorë të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkohen lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditorë të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional,
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë,
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera,
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit,
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve,
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale,
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësisimit profesional dhe kolektiv në repart(njësi),
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj,
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka,

- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditorë,
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike,
- Sipas radhës punë në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe bënë ekzaminimin-pranimin e tyre.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Licenca e Specialistit të lemisë përkatëse;
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme;
- Letërnjoftimi fotokopje ose leja e banimit të përkohshëm, dhe
- Certifikata e lindjes, fotokopje.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë, shtetas të Republikës së Kosovës, Mjekë specialist të lëmvive përkatëse që nuk janë të punësuar në Institucionet Publike Shëndetësore gjegjësisht në Institucionet publike.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kushtet e konkursit.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit të QKUK-së, ndërtesa e re e Administratës ose me Telefon nr. 038/512-667.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit. Nuk do të pranohen aplikacione ndryshe nga dëshmitë që kërkohen më këtë konkurs.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas këtij konkursi, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 ☎ +386 49 848 553

Prishtinë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SIISKUK)-Univerziteteske Bolničke i Kliniçe Službe Kosova (UBKSK) - Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Univerziteti Kliniçi Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosova
Kadrovska Služba

Prema članu 8, tačka 1 i 2, Zakona o radu br. 03/L-212, člana 4, Administrativnog Uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, člana 6. tačka 1.1 i član 13 tačka 1 i 3. Statuta Bolničke Službe i Univerziteteskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), člana 12 i član 13 tačka 1. Statuta Kliničkog Univerziteteskog Centra Kosova; kao i član 62, stav 6, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo; Član 5, Uredbe o Radnim Odnosima br. 1003 datum 21.07.2016; i Elektronski Zahtev dana 27.03.2019, Generalni Direktor UBKSK, raspisuje:

KONKURS

Institucije: Univerziteti Bolničke i Kliniçe Službe Kosova. (UBKSK)
Univerziteti Kliniçi Centar Kosova (UKCK)

Nr	Traženo:	Klinika - Instituta:	Potreb.br
1	Lekar Specijalisti Oftalmologije	Oftalmološka Klinika	1
2	Lakar Specialista Neurologije	Neurološka Klinika	1
3	Lekar Specialista Urologije	Urološka Klinika	1
4	Internistički specijalista za potrebe Intenzivne Centralne Medicine	Klinika za Anesteziologiju i Intenzivnu Njegu	1

Koeficijent zarade: (8.40) Za Lekara specialista,
Radna Vreme: Puno radno vreme,
Ugovor:
Izveštaj: Šefu Odeljenja za Klinike u UKCK.
Referentni br. UKCK - 13/2019-04/4

I. Osnovna svrha posla – za specialista:

Pružanje zdravstvenih usluga u pogledu kvaliteta i kvantiteta zasnovane na profesionalnom nivou koj je ima.

Ključne odgovornosti lekara specijalista:

- Zajedno sa šefom odeljenja i ostalih nadzornog osoblja upravlja ljudskim resursima, opreme, objekata inventar za nivo na kome pripada.
- obezbedi visok standard nege pacijenata.
- Ljubaznost, briga i poštovanje za pacijente i osoblje radi.
- Ljubaznost i saradnja sa drugim osoblje koje radi profesionalno.
- Prijem, ispitivanje i lečenje pacijenta u pitanju.
- Redovno identifikaciju putem medicinske dokumentacije (istorija bolesti, otpusni list, protokol, itd) pacijenta.
- Izvršiti redovne posete bolničko lečenje u zdravstvenoj ustanovi.
- Napravljani zahteva za dodatnim konsultativne posete,
- Vršiti nadzor primene dnevnih radnih zadataka radne osoblja.
- Daje stručna mišljenja za rad koji obavljaju.
- Obavlja i druge poslove u skladu sa supervizora za rad u instituciji u kojoj je zaposlen.
- Vršiti konkretne zadatke kada je to potrebno u vezi sa profesijom stručnjaka koji je blisko.
- Odgovoran je za izradu nastavnog plana i programa njegovog rada individualnih i kolektivnih na radnom mestu,
- Anagažuje osoblje koje radi u realizaciji svakodnevnih radnih zadataka,
- Obezbediti i razviti programe stručnog osposobljavanja,
- Vršiti redovnu kontrolu (inspekciju objekata, opreme i inventara na radnom mestu).
- Proverite da li je okruženje je čist i bezbedan za sve,
- Upravlja potrošnog materijala i druge opreme,
- Obezbeđuje efikasnog sistema komunikacije za sve unutar institucije,
- Analizira i realizuje profesionalne protokole pacijenta,
- Učestvovanje u stručnim naučnim istraživanjima,
- Preduzima mere za povećanje menadžerskih kvalitete i jedinicu kolektivne na odeljenje (Jedinice)
- Izvršiti dodatne zadatke na osnovu njihove profesionalne kvalifikacije i upravljanje, itd
- Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom smislu zasniva na profesionalnom nivou tamo,

- Davanje stručne savjete u tumačenju o lečenju pacijenata i postavljanje dan tretmana,
- Odredi redosled i plan kliničko-laboratorijskih egzaminacija,
- Da bi se rad u klinici ambulantno i ispituje njihovu readmisiju.

Obrazovanje je potrebno: Da ima univerzitetisku diplomu iz oblasti na osnovu specifičnosti institucije

- * Diploma Medicinskog Fakulteta;
- * Licenca specijalista odgovarajuće kategorije specialista;
- * Prioritet će biti dat kandidatima koji imaju posebnu obuku i dobro poznavanje funkcionisanja zdravstvenog sistema na Kosovu;
- * Da ima dokazali veštine i efikasne komunikacije u pismeno i usmeno, imaju znanje službenih jezika u upotrebi;
- * Poznavanje rada sa kompjuterom je od suštinskog značaja i znanje engleskog jezika je povoljno;
- * Licna karta fotokopija ili privremeni boravak i
- * Izvod matične knjige rođenih, fotokopija.

Uslovi učešća u zapošljavanju: pravo da se konuriše imaju svi građani Republike Kosova, odraslih koji imaju punu pravnu sposobnost, su završili svoje obrazovanje - lekari specijalisti različiti poljima, koji nisu zaposleni u institucijama za javno zdravlje, odnosno javnim institucijama.

Uslovi radova konkursa: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Datum zatvaranja konkursa: **15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.**

Podnošenje konkursa: Aplikacija se uzimaju i dostavlja - Sektor kadrovski UKCK, u novoj Administrative Zgrade ili telefonom br. 038/512-667.

U Aplikaciji treba jasno navesti naziv radnog mesta i referentni broj. Sva dokumenta i dokaz profesionalno da se pridruži aplikaciju.

Podnete aplikacije po isteku roka i nepotpune aplikacije neće biti prihvaćene.

Kandidati pruži dokaze pod objavljivanjem konkursa, kandidati koji inače ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na intervju.

Generalnog Direktora UBKSK

Dr. Basri Sejdiu

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office Of The Prime Minister

Në mbështetje të nenit 7 pika 1 dhe 5 e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës, të nenit 6, 7 dhe 8 të Rregullores nr.10/2017 për Detyrat, Përgjegjësit dhe Organizimin e Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Zyra e Kryeministrit shpall:

KONKURS

Për Zëvendës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Kriteret që duhet ti plotësojnë kandidatët për përzgjedhjen e Zëvendës drejtorit janë:

- Letër motivimi me shpjegime të qarta dhe shembuj nga provoja profesionale që tregojnë se si provoja dhe aftësitë përputhen me kërkesat e vendit të punës,
- Diplomë Universitare në fushën relevante,
- Së paku tetë (8) vjet përvojë pune profesionale të cilat së paku pesë (5) vjet përvojë në pozitën udhëheqëse,
- Të ketë aftësi të larta organizative dhe drejtuese,
- Të ketë aftësi të larta të komunikimit dhe negocimit,
- Të jetë njohës i fushës së të drejtës pronësore.

Drejtori dhe Zëvendës drejtor emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit nga Kryeministri me mandat pesë (5) vjeçar pa të drejtë rizgjedhje.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për Zëvendës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, duhet të dorëzojnë këto dokumente.

CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë

Letër motivimin

Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)

Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime Shtetas i Republikës së Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i pozitës në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohen në Zyrën e Sekretariatit Koordinues të Qeverisë në Zyrën e Kryeministrit, Ndërtesa e Qeverisë, kati i I-rë, zyra nr. 100.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet, origjinalet mund të kërkohen nga komisioni përzgjedhës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/200 14 400.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (nga data 01 prill 2019 deri me 16 prill 2019).



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office Of The Prime Minister

Na osnovu člana 7. tačka 1. i 5. Zakona br. 05/L-010 o Kosovskoj agencije za poređenje i proveru imovine, člana 6, 7. i 8 Uredbe br.10/2017 o zadacima, odgovornostima i organizaciji Izvršnog sekretarijata Kosovske agencije za poređenje i proveru imovine, Kancelarija premijera objavljuje:

KONKURS

Za zamenika direktora Izvršnog sekretarijata Kosovske agencije za poređenje i proveru imovine.

Kriterijumi koje trebaju ispuniti kandidati za izbor direktora i zamenika direktora su:

- Motivaciono pismo sa jasnim objašnjenjima i primerima iz stručnog iskustva koje pokazuje da iskustvo i sbosobnosti se poklapaju sa zahtevima radnog mesta,
- Univerzitetska diploma u relevantnoj oblasti,
- Najmanje osam (8) godina stručnog radnog iskustva, od čega najmanje pet (5) godina radnog iskustva na rukovodećem položaju,
- visoke organizacione i rukovodeće sposobnosti,
- Velike veštine komunikacije i pregovaranja,
- Poznavalac oblasti imovinskih prava.

Zamenika direktora imenuje Skupština Republike Kosova na predlog premijeram, na mandat od pet (5) godina, bez prava na reizbor.

OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA KONKURISANJA

Kandidati za zamenika direktora Izvršnog sekretarijata Kosovske agencije za poređenje i proveru imovine treba da podnesu sledeće dokumente.

CV sa primerima dostignuća u radu

Motivaciono pismo

Dokumente predvidjene u uslovima zapošljavanja (dokaz o stručnoj spremi, radno iskustvo)

Uverenje (dokaz) koje dokazuje da nije pod istragom

Državljanin Republike Kosovo (kopija pasoša ili lične karte)

Dokumentacija treba da bude u zatvorenoj koverti u kojoj ja napisano ime i prezime i naziv pozicije za koju kandidat konkuriše i ista se dostavlja Kancelariji generalnog sekretara Kancelarije premijera, zgrada Vlade, I sprat, kancelarija br. 100.

Predata dokumentacija se ne vraća, originale može zatražiti komisija za selekciju.

Dodatne informacije možete dobiti putem telefona 038/200 14 400.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnom novinama (od 01.04.2019 do 16.04.2019 godine).

Kërkesa për shprehje të interesitEmri i shkollës: **SHFMU "Haki Stërmilli"-Zoqishtë/Rahovec**Komuna: **Rahovec**Data: **01. 04.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/094-CS/1.1	Trajnimi i mësimdhënësve për TIK

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **SHFMU "Haki Stërmilli"-Zoqishtë/Rahovec**.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

Trajnim: Trajnimi i mësimdhënësve për TIK

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në pesë vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Programi i trajnimit i licencuar nga MASHT dhe me licencë valide (20%).

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **SHFMU "Haki Stërmilli"-Zoqishtë/Rahovec** më së largu deri më **09. 04. 2019**

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Ilir Kryeziu
Telefoni: +38344280546
E-maili: ilir_kryeziu81@hotmail.com

Diart Morina
+38345884673
morinadiart120@hotmail.com

SHPALLJE PUBLIKE PËR PRANIM TË OFERTAVE

Në përputhje me dispozitat e nenit 4; nenit 11;nenit 14 dhe nenit 16/3 të ligjit për lirinë e asociimit të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të statutit të LSHK-së, **Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës**, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE PËR PRANIM TË OFERTAVE

QËLLIMI: FTESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT PËR OFERTIM

OBJEKT INTERESIMI I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE TË KOSOVËS ËSHTË BLERJA E NJË PATUNDSHMËRIE NË SIPËRFAQE PREJ 150-200 METRASH KATRORE.

Përparësi kanë lokacionet e përshtatshme, që gjenden në qendër ose sa më afër saj, si dhe ato lokale, që kanë çmim më të volitshëm dhe infrastrukturë shtesë.

- 1 Ftohen të gjitha subjektet e së drejtës (personat juridik dhe fizik), që të ofertojnë me ofertat e tyre brenda afatit të caktuar.
- 2 Ofertuesit duhet të dërgojnë gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe të dëshmojnë se janë pronarë ligjorë dhe legjitim të patundshmërive, të cilat i ofrojnë për shitblerje, përkatësisht që i kanë përmbushur obligimet ligjore ndërtimore dhe se janë të pajisur me të gjitha lejet, që kërkohen me ligj dhe me akte të tjera nënligjore.
- 3 Ofertat e ofertuesve me dokumente të skanuara e të kompletuara, dërgohen në postën elektronike të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës: lshk2012@yahoo.com, tel. 044 158 324.
- 4 Dokumentacioni i pakompletuar nuk merret në shqyrtim.
- 5 Afati i ofertimit është 10 ditë, nga dita e shpalljes në mediet e shkruara ditore (gazeta) dhe në uebfaqen e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.
- 6 Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës në një afat të arsyeshëm kohor do t'i njoftojë me shkrim ofertuesit, përkitazi me pranimin ose jo të ofertës së tyre.

Oferta që pranohet duhet të depozitohet garanci bankare prej 24.000 eurosh. Afati i garancisë deri më 1.04.2020.

PRISHTINË, 1.04.2019 KRYESIA E LSHK-së.

Kërkesa për shprehje të interesitEmri i shkollës: **"SAPNIQI"**Komuna: **Rahovec**Data: **1.04.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/099 - ESIP/SDG/099-CS/1.1	Trajnimi i mësimdhënësve për TIK

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **"Sapniqi" Sapniq - Rahovec**.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

Trajnim: **Trajnimi i mësimdhënësve për TIK**

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "SAPNIQI" Sapniq, Rahovec**, më së largu deri më **09. 04. 2019**.

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Xhafer Gashi
Telefoni: 044/767127
E-maili: msusigjaf05@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Gani Avdiu shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit juridik të universitetit të Prishtinës.

► Ekrem Avdullah Kryeziu shpall të pavlefshme dokumentet si në vijim: 1. Diplomën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Luciano Motroni", Prizren. 2. Dëftesën e vitit të parë të Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Luciano Motroni", Prizren. 3. Dëftesën e vitit të dytë të Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Luciano Motroni", Prizren. 4. Dëftesën e vitit të tretë të Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Luciano Motroni", Prizren. Dëftesën e vitit të katërt të Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Luciano Motroni", Prizren. Periudha e shkollimit: 1991-1995.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 bane-sa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm për banim kolektiv. Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

